

1 E hënë, 23 tetor 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 09.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëmëngjesi. Mirë se keni ardhur.

7 Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar  
9 Gjykatës. Kjo është lënda KSC-BC-2020-04, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Pjetër Shalës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Pikë së pari, u lutem të pranishmëve të prezantohen.

14 Në emër të Prokurorisë keni fjalën.

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse.

16 Për ZPS-në Line Pedersen, Filippo De Minicis, Federica  
17 Genivese.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

19 Faleminderit.

20 Mbrojtësi i Viktimave?

21 Z. LAWS: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse. Jam  
22 Mbrojtësi i Viktimave së bashku me bashkëmbrojtësen Maria  
23 Radziejowska.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

2 Z. GILISSEN: [Përkthim]. Jam Jean-Louis Gilissen. Z.  
3 Pjetër Shala na ndjek përmes videolidhjes. Jam bashkë  
4 bashkëmbrojtësin z. Hedi Aouini dhe znj. Leto Cariolou. Kemi  
5 dhe dy asistentë, Juliette Healy, Judit Kolbe edhe kemi dhe  
6 një stazhiere Lidia Veliu. Faleminderit shumë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Faleminderit.

9 Z. Shala, ju lutem na konfirmoni nëse dëgjoni mirë?

10 I AKUZUARI:[Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes. Ju ndëgjoj  
11 shumë mirë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
13 mirë. Në rregull.

14 Sot do të dëgjojmë dëshminë dëshmitarit të katërt të  
15 Mbrojtjes, Dëshmitari me numër 4754, z. Mark Shala. Përpara se  
16 të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, do të trajtojmë disa  
17 çështje procedurale të papërfunduara ende. Pas përfundimit të  
18 dëshmisë së dëshmitarit sot edhe nesër, do të shikojmë, Trupi  
19 Gjykues do të trajtojë dhe do japë vendim për dy çështje të  
20 tjera shtesë.

21 Së pari, Trupi Gjykues do të lexojë për procesverbalin  
22 një vendim që ka lëshuar me postë elektronike ditën e mërkurë  
23 javën që shkoi, 18 tetor në orën 12.54 lidhur me kërkesën e  
24 ZPS-së për zgjatje të afatit për t'ju përgjigjur kërkesës së  
25 parë të Mbrojtjes për pranimin e provave jогоjore me shtojcën

1 jokonfidenciale numër 1, që është parashtrim i protokolluar  
2 688 i datë 13 tetor 2023.

3 Kërkesën e ZPS-së e kemi marrë me postë elektronike po  
4 ditën e mërkurë më datë 18 tetor, në orën 8.31 minuta.

5 Më konkretisht, pasi konstatoi se kërkesa është bërë  
6 mjaftueshëm paraprakisht për t'i dhënë mundësi Trupit Gjykses  
7 për të marrë vendim për kërkesën përpara përfundimit të  
8 afatit, ZPS-ja ka dëshmuar arsye të vlefshme duke pasur  
9 parasysh që ka dhe afate dhe detyrime të tjera në këtë fazë,  
10 zgjatja e afatit është minimale, nuk do ta vonojë procesin dhe  
11 që Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk kundërshtojnë.

12 Trupi Gjykses, në bazë zë rregullës 9(5)(a) dhe rregullës  
13 76 të Rregullores, e kanë miratuar kërkesën dhe i kanë dhënë  
14 urdhër ZPS-së që ta dorëzojë përgjigjen e vet brenda të  
15 premtës, 27 shtator 2023.

16 Kjo është bërë e ditur palëve dhe pjesëmarrësve, po kjo  
17 është mënyra jonë sesi ta bëjmë publik këtë vendim pa një  
18 parashtrim të protokolluar shtesë.

19 Këtu mbyllet ky vendim gojarisht i Trupit Gjykses.

20 Së dyti, Trupi Gjykses dëshiron që t'i kthehet një pike  
21 të ngritur nga Mbrojtja në bllokun e fundit të dëshmitarëve  
22 gjatë kundrapyetjeve që i janë bërë dëshmitarit. Bëhet fjalë  
23 për dëshmitarin e gjashtë, pra, nuk është blloku i fundit i  
24 dëshmitarëve. Gjithsesi është transkripti i seancës së 21  
25 shtator 2023, në faqen 2677, rreshti 15 deri në faqen 2678,

1 rreshti 8. Trupi Gjykues udhëzon ZPS-në që në të ardhmen të  
2 nxjerrë çdo material provues që rrjedh nga çështje, pra,  
3 procese të tjera të cilat po zhvillohen në DHSK paraprakisht,  
4 përpara se t'ua bëjë pyetjet dëshmitarëve. Kjo do t'i jepte  
5 mundësi Trupit Gjykues, Mbrojtjes dhe Mbrojtësit të Viktimave  
6 që të përgatiten edhe ata për këto pyetje. Faleminderit.

7 Këtu mbyllet ky udhëzim i yni.

8 Së treti, dhe është vendimi i tretë që kemi, Trupi  
9 Gjykues do të lëshojë një urdhër gojarisht lidhur me kërkesën  
10 e Mbrojtjes që gjatë bërjes së pyetjeve të Dëshmitarit 4754 të  
11 përdorë një material të nxjerrë rishtazi. Me numër DPS01571,  
12 që është një fotografi. Kërkesa është bërë me postë  
13 elektronike të hënën, më datë 16 tetor 2023, në orën 17.06  
14 minuta. Materiali është nxjerrë në të njëjtën ditë që është  
15 paketa 171 e nxjerrjes së materialit dhe është shtuar në  
16 listën e prezantimit për këtë dëshmitar.

17 Pas kundërshtimit të ZPS-së me postë elektronike datë 18  
18 tetor 2023 në orën 8.36 minuta, pra, kundërshtim kundër  
19 përdorimit këtij materiali, Mbrojtja iu kundërpërgjigj me  
20 postë elektronike, po më në datë 18 tetor, në orën 15.39, me  
21 sugjerimin që të përdorë dy materiale alternative të nxjerra  
22 rishtazi me këta numra, DPS01586 dhe DPS01587, të dyja janë  
23 fotografi të cilat janë nxjerrë në të njëjtën ditë me paketën  
24 172 të materialit të nxjerrë.

25 Pasi mbajti shënim kundërshtimin e ZPS-së dhe

1 kundërpërgjigjen e Mbrojtjes, Trupi Gjykues me këtë vendim i  
2 lejon Mbrojtjes që të përdorë njërin prej dy materialeve të  
3 nxjerrë rishtazi, që është me numër DPS01587, gjatë pyetjeve  
4 që do t'ia bëjë Dëshmitarit 4754.

5 Këtu mbyllet ky urdhër i lëshuar gojarisht.

6 Mund të fillojmë tani me dëshminë e dëshmitarit.

7 Shoh që Avokati Mbrojtës është ngritur në këmbë.

8 Keni fjalën.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës. Për  
10 të korrigjuar transkriptin në faqen 3, rreshti 3, për afatin  
11 për ZPS-në, besoj se është e premtë 27 tetor 2023 dhe jo 7.  
12 Thjesht për ta korrigjuar.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.  
14 Mos e kam thënë unë ndryshe, por është e sigurt që është data  
15 27. Thjesht me dy ditë më shumë është shtuar, është zgjatur.  
16 Faleminderit shumë.

17 Atëherë z. Mark Shala do të dëshmojë pa masa mbrojtëse në  
18 sallën e gjyqit. Do të zhvillojmë seancat tona të rregullta  
19 prej një orë e gjysëm me pushimet si zakonisht.

20 Znj. Asistente e sallës, ju lutem shoqërojeni dëshmitarin  
21 të hyjë në sallë.

22 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
24 Dëshmitar, mirëmëngjesi dhe mirë se keni ardhur në Dhomat e  
25 Specializuara.

1 DËSHMITARI: Mirëmëngjesi dhe ju përshëndes të gjithëve  
2 këtu që jeni prezentë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
4 lutem më konfirmoni nëse më dëgjon mirë?

5 DËSHMITARI: Mirë ju ndëgjoj.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Faleminderit.

8 Z. Shala, e dëgjoni përkthimin?

9 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po. Po, e ndëgjoj mirë.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11 Faleminderit.

12 Z. Dëshmitar, si jeni sot?

13 DËSHMITARI: Mirë. Mirë shumë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sot  
15 do të fillojmë me dëshminë tuaj. Në fillim, përpara se t'ju  
16 bëjmë pyetje kam disa gjëra për t'jua thënë.

17 Z. Dëshmitar, ju kanë thirrur të dëshmoni përpara Dhomave  
18 të Specializuara në çështjen gjyqësore Prokurori i  
19 Specializuar kundër z. Shala për ta ndihmuar Trupin Gjykses që  
20 të marrë një vendim.

21 Pikë së pari, do të mbani deklaratën solemne për të thënë  
22 të vërtetën pas së cilës do t'ju bëjnë pyetje në fillim  
23 Avokati i Mbrojtjes në emër të z. Pjetër Shala, pastaj nga ana  
24 tjetër përfaqësuesit, ata me rroba ngjyrë vjollcë,  
25 përfaqësuesit e Prokurorisë, Zyrës së Prokurorit të

1 Specializuar dhe pastaj Mbrojtësi i Viktimave. Në fund edhe  
2 Trupi Gjykses mund t'ju bëjë pyetje.

3 Përpara se të bëni deklaratën solemne për të thënë të  
4 vërtetën, do t'ju jap disa udhëzime, do t'ju jap disa këshilla  
5 praktike për përgjigjet, më dëgjoni me vëmendje ju lutem.

6 Z. Dëshmitar, nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund  
7 të kërkoni që pyetja t'ju përsëritet. Duam që të na thoni të  
8 vërtetën. Vërejt që po pohoni me kokë. Pra, dua që të na  
9 tregoni se çfarë keni parë vetë, çfarë keni përjetuar vetë,  
10 çfarë keni dëgjuar, çfarë keni ndjerë vetë. Nëse nuk e keni  
11 parë apo dëgjuar ju vetë, por e keni marrë vesh me ndonjë  
12 mënyrë tjetër na e thoni, pra, sesi e keni marrë vesh një  
13 fakt.

14 Mund të mos ju kujtohet të gjitha hollësitë e ngjarjeve,  
15 nuk ka problem për këtë. Ju lutem dëshmoni vetëm për ato që  
16 dini. Mos merrni me mend gjëra, mos sajoni gjëra. Nuk ka asgjë  
17 të keqe të thoni "nuk e do" apo "nuk më kujtohet".

18 Ju lutem, përgjigjuni vetëm pyetjeve që do t'jua bëjnë.  
19 Se po të kemi nevojë për më shumë sqarime, mund t'ju bëhen  
20 pyetje të tjera pastaj.

21 Dhe, në fund, ju rikujtoj se keni të drejtën që të  
22 kundërshtoni që të jepni dëshmi për gjëra të cilat mund t'ju  
23 fajësojnë në bazë të rregullës 151(1) të Rregullores.

24 Z. Dëshmitar, a i kuptoni të gjitha këto?

25 DËSHMITARI: Po.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kam  
2 tani edhe disa këshilla praktike. Ju lutem dëgjojini me  
3 vëmendje.

4 Gjithçka që ne themi këtu përkthehet dhe regjistrohet,  
5 prandaj dhe është me rëndësi që të flisni afër mikrofonave që  
6 keni përpara, të flisni qartë dhe të flisni ngadalë, sepse kjo  
7 u jep mundësi përkthyesve që të përkthejnë gjithçka për të  
8 gjithë të pranishmit por edhe për ata që na ndjekin nga jashtë  
9 sallës.

10 Ju lutem, filloni të flisni vetëm mbasi të ketë  
11 përfunduar pyetjen personi që ua bën pyetjen, që të mos ketë  
12 mbivendosje të folësve sepse pastaj komunikimi këtu në sallën  
13 e gjyqit bëhet i pamundur. Pra, prisni edhe pesë sekonda mbasi  
14 të ketë mbaruar pyetjen, ndonjëherë u them personave që të  
15 numërojnë me vete deri në pesë, veproni si ta gjykoni ju të  
16 arsyeshme, por prisni njëherë, pastaj filloni të jepni  
17 përgjigjen sepse kjo i jep mundësi edhe përkthyesve që të  
18 mbyllin përkthimin e pyetjes njëherë dhe pastaj të bëjnë  
19 përkthimin e përgjigjes tuaj.

20 Nëse unë ngre dorën kështu, ju lutem mos flisni më. E bëj  
21 këtë gjest sepse nuk dua unë të flas ndërkohë që flisni ju,  
22 prandaj dhe ngre dorën vetëm. Ndonjëherë mund t'ju kërkojmë të  
23 dilni nga salla e gjyqit, në mënyrë që ne këtu të mund të  
24 diskutojmë disa gjëra lidhur me përmbajtjen e pyetjeve apo të  
25 dëshmisë suaj.



1 Nëse ju keni ndonjë pyetje, nëse keni nevojë për një  
2 pushim, nëse keni diçka tjetër që doni t'ia thoni Gjykatësve,  
3 ju lutem ngrini dorën, në këtë mënyrë unë do ta kuptoj që doni  
4 të merrni fjalën.

5 Në fund kam edhe një këshillë tjetër praktike. Mund t'ju  
6 kërkohet që të bëni ndonjë shënim në dokumentet digjitale që  
7 do ju tregohen në kompjuterin që keni përpara. Do t'ju japim  
8 një laps elektronik, ashtu mund të bëni edhe shënimet tuaja.

9 I kuptuat edhe këto të gjitha, z. Dëshmitar?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
12 rregull. Si me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj tani që të bëni  
13 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj, z.  
14 Shala, se përbën veprë penale dhënia e dëshmisë së rreme në  
15 juridiksionin e Dhomave të Specializuara, pra, dhënia e  
16 dëshmisë së rremë në këtë sallë gjyqi. E kuptoni këtë?

17 DËSHMITARI: Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
19 mirë.

20 Znj. Asistente e sallës, jua ka dhënë tekstin e  
21 deklaratës. Ju lutem filloni.

22 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime  
23 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të  
24 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
25 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

1 DËSHMITARI: W04754

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim për të thënë  
4 të vërtetën.

5 Tani mund të fillojmë me dëshminë tuaj, pyetjet do të  
6 fillojë t'i bëjë Avokati i Mbrojtjes.

7 Z. Avokat, keni kërkuar tre orë për pyetjet që do t'ia  
8 bëni këtij dëshmitari, ju lutem informoni pastaj Trupim  
9 Gjykes për çdo ndryshim që mund të keni për arsye  
10 planifikimi. Keni fjalën.

11 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

12 Pyetje nga z. Aouini:

13 Z. AOUINI: [Përkthim]

14 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar.

15 PË. Mirëdita.

16 PY. Siç e përmendi shkurtimisht Kryegjykatësja, unë jam z.

17 Aouini, një prej avokatëve që përfaqësojnë z. Pjetër Shala në  
18 këtë proces dhe do t'ju bëj disa pyetje.

19 Z. Dëshmitar, ju lutem që të fillojmë me emrin dhe  
20 mbiemrin tuaj për procesverbalin.

21 PË. Po. Unë quhem Mark Shala.

22 PY. Z. Mark Shala, ndonjë nofkë a emër tjetër a keni?

23 PË. Jo, përpos emrit.

24 PY. Faleminderit. Ju lutem na thoni datëlindjen dhe  
25 vendlindjen.

1 PË. Jam i lindur më 26 mars 1961 në fshatin Gurrakoc, komuna  
2 e Istogut.

3 PY. Në Kosovë, kështu?

4 PË. Në Kosovë, po.

5 PY. Faleminderit. Aktualisht tani ku banoni, z. Dëshmitar?

6 PË. Po kohë pas kohe jetoj edhe në Kosovë, por në kohën e  
7 fundit ma shumë në Kroaci.

8 PY. Cila është shtetësia juaj. Apo cilat janë shtetësitë  
9 tuaja nëse keni më shumë se një shtetësi?

10 PË. Po i kam dy nënshtetësi. E kam nënshtetësinë të  
11 vendlindjes, domethënë, të Kosovës dhe nënshtetësinë e  
12 Kroacisë.

13 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, çfarë pune bëni sot?

14 PË. Për momentin jam në pension, qysh nga 2015.

15 PY. Po përpara çfarë pune bënit?

16 PË. Përpara kam qenë deri në atë moment që kam dalë në  
17 pension kam punu në Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
18 në Kosovë.

19 PY. Po përpara kësaj çfarë pune, keni pasur ndonjë tjetër?

20 PË. Para FSK-së kam qenë pjesëtar i Trupave të Mbrojtës të  
21 Kosovës prej vitit, domethënë, në fund të vitit 1999 deri në  
22 transformimin e TMK-së në FSK.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

24 Avokat, ju lutem nëse mund të përcaktoni se çfarë funksioni ka  
25 pasur dëshmitari në Ministrinë e Forcave të Sigurisë?

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, e nderuar Gjykatëse. Unë po  
2 propozoja që t'i ndiqnim këto me radhë, po mund ta bëjmë.

3 PY. Z. Dëshmitar, ju përmendët se kishit një rol në forcat e  
4 sigurisë në Kosovë. Mund të na e thoni se çfarë roli? E kemi  
5 fjalën për punën e fundit atë që e keni pasur deri në vitin  
6 2015. Çfarë roli keni pasur aty?

7 PË. Po, e kam kry disa funksione. Kam qenë në Departamentin e  
8 Sigurisë në një kohë dhe pastaj kam kalu në kabinetin e  
9 Ministrisë të Forcës së Sigurisë. Kam qenë këshilltar politik i  
10 Ministrisë të Forcës së Sigurisë.

11 PY. Z. Dëshmitar, çfarë kualifikimesh, çfarë formimi apo  
12 studimesh keni kryer ju përpara se të fillonit punën?

13 PË. Po unë sa i përket shkollimit, unë shkollën fillore dhe  
14 shkollën e mesme e kam kry në vendlindje. Kurse pas shkollës  
15 së mesme e kam vazhdu akademinë ushtarake të ish-Jugosllavisë.  
16 Jam regjistru në Beograd. Dy vitet e para i kam kry në  
17 Beograd. Kurse specializimin dhe dy vitet e fundit i kam të  
18 kry në Sarajeve, në Bosnjë-Hercegovinë.

19 PY. Faleminderit. Ju lutem, shkurtimisht na tregoni pas  
20 diplomimit nga akademia ushtarake, ku e keni kryer shërbimin  
21 nga cila kohë deri në cilën kohë dhe në cilin vend. Ngadalë po  
22 shkurt.

23 PË. Pas kryerjes së akademisë ushtarake, jam caktu me detyrë  
24 në Kroaci në një vend i cili quhet Gospiç dhe aty ia kam fillu  
25 karrierës sime si oficer i karrierës.

1 PY. Po një periudhë kohore nëse mund të na jepni, një datë?

2 PË. Po. Prej vitit, domethënë, prej muajit gusht 1985 deri në  
3 muajin gusht 1991, kam punu në armatën e ushtrisë jugosllave  
4 në Gospiç.

5 PY. Çfarë roli apo titulli, pra, çfarë pune kryenit aty në  
6 atë periudhë?

7 PË. Fillimisht kam qenë komandant kompanie, diku një vit, një  
8 vit e dy-tre muaj. Pastaj kam punu në departamentin e  
9 logjistikës në garnizonin e Gospiçit deri në mbarim të  
10 karrierës.

11 PY. Pra, vjen në vitin 1991 në Gospiç. Na thatë që ishit në  
12 Sarajevë atëherë. Mund të na thoni çfarë posti e patët aty nga  
13 viti 1991 e më këtej, nëse mundet?

14 PË. Jo, deri në vitin 1991 kam qenë si pjesëtar i ushtrisë së  
15 Jugosllavisë. Por në atë kohë në Kroaci kanë fillu këto  
16 luftimet në mes -- Kroacia ka qenë e sulmume nga ana e  
17 ushtrisë jugosllave dhe serbe dhe unë atëherë e kam braktis  
18 armatën jugosllave dhe kam kalu në armatën e Kroacisë.

19 PY. Faleminderit që e sqaruat. Në cilin moment, pra, në cilën  
20 datë iu bashkuat ushtrisë kroate dhe me çfarë posti aty?

21 PË. Fillimisht, ku pasi që e kam braktis armatën jugosllave,  
22 dikun ka fundi i muajit gusht 1991, për një kohë kam shku për  
23 ata larguar familjen time që në atë kohë ishte në Kosovë, ka  
24 qenë bashkëshortja ime dhe dy vajzat. Ata i kam largu nga aty  
25 për arsye se ishin të rrezikum edhe ata, por edhe unë, se unë

1 nuk e kam lëshu armatën jugosllave me vetëdëshirë, por e kam  
2 braktisë dhe kam qenë i kërkuar nga organet shtetërore. E kam  
3 marrë familjen dhe në përmes Shkupit i kam dërgu, i kam çu  
4 deri në Zvicër.

5 PY. Faleminderit. Ju lutem shkurtimisht na shpjegoni sesi ju  
6 bashkuat ushtrisë kroate dhe ku?

7 PË. Pasi që i kam strehu familjen në Zvicër dhe kam qenë i  
8 sigurt se ata janë në duart të sigurta, atëherë kam ra në  
9 kontakt me disa eprorë që unë i kam njoftë nga e kaluara dhe  
10 jam marrë vesh me ta që të kthejna, të vij, të kthejna, të  
11 vijë në ushtrisë së Kroacisë. Dhe pasi dikund afër pas tre  
12 muajve jam kthy dhe iu kam bashkangjitur ushtrisë së Kroacisë,  
13 diku në fillim të vitit 1992.

14 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Sa kohë keni shërbyer në  
15 ushtrinë kroate? Pra, nga viti 1992 deri kur?

16 PË. Nga viti 1992 deri në vitin 1999.

17 PY. Çfarë roli apo funksioni keni kryer në ushtrinë kroate?

18 PË. Kam kry detyra të ndryshme. Kam qenë një kohë në  
19 operativë. Pas një kohe, përsëri kam kalu në atë specializimin  
20 tim që e kam pasë nga akademia, kam kalu në departamentin e  
21 logjistikës dhe kam punu me atë departament.

22 PY. Faleminderit. Kur thoni specializimin tuaj është  
23 logjistika, apo jo?

24 PË. Po.

25 PY. Ju lutem, juve na thatë se i keni shërbyer në ushtrinë

1 kroate deri në vitin 1999. Në ç'rrethana e ndërpretë këtë

2 shërbim në ushtrinë kroate?

3 PË. Ushtrinë e Kroacisë e kam ndërpre në atë moment kur më

4 është kërku apo kur janë bë kushtet që të lëshoja atë armatë

5 dhe t'i bashkangjitna Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

6 PY. Cili ishte posti i fundit që keni pasur në armatën

7 kroate? Me çfarë grade?

8 PË. Armatën e Kroacisë e kam -- vërtetë jam liru nga armata e

9 Kroacisë me gradën nënkolonel.

10 PY. Faleminderit. Përmendët se e lëshuat armatën kroate për

11 t'ju bashkëngjitur Ushtrisë Çlirimtare, besoj e keni fjalën

12 për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës --

13 PË. Të Kosovës.

14 PY. -- në vitin 1999?

15 PË. Po, po.

16 PY. A kishit pjesëtarë të afërt të familjes që jetonin në

17 Kosovën në 1999?

18 PË. Po. I kam pasë në Kosovë nga prindët, nënën, vëllaun e

19 madh që është dy vite më i vjetër se unë, me familjen e tina,

20 domethënë, me bashkëshorten dhe fëmijët e tij. E kam pasë

21 motrën me familje. Kurse të tjerët kanë qenë jashtë Kosove.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

23 Avokat, kam përshtypjen që dëshmitari nuk iu përgjigj pyetjes

24 suaj në faqen 13, rreshti 20, ku përmendët datën ose të paktën

25 vitin kur ai ju bashkua UÇK-së. Do të doja të më jepet data

1 apo momenti kohor kur ai u largua nga ushtria kroate. Dhe  
2 përgjigja ishte në fakt Ushtria Çlirimtare e Kosovës por nuk  
3 ishin momentet kohore, datat?

4 Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Këtë e kemi shkurtimisht në  
5 faqen 12, rreshti 24, por do ta shtjellojë këtë më shumë, këtë  
6 pjesë, këtë tranzicion pra. Rreshti 24, faqja 12, mendoj se  
7 përmendi që bëhej fjalë nga 1991 deri në 1999. Do ta sqaroj më  
8 tej këtë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit. Në qoftë se mund të jeni pak më të saktë lidhur  
11 me këtë.

12 Z. AOUINI: [Përkthim]  
13 PY. Z. Dëshmitar, keni ndonjë datë të saktë apo momente  
14 kohore të sakta nën vitin 1999, në qoftë se ju kujtohet muaji  
15 i vitit kur ju i jeni bashkuar Ushtrisë çlirimtare të Kosovës?  
16 PË. Po, sigurisht. Kjo ka qenë dikun ka fundi i muajit mars,  
17 domethënë, muajit të tretë, 1999. Data saktësisht mundet me  
18 qenë 26, diçka qashtu.

19 PY. Faleminderit. Atëherë ku shkuat për t'ju bashkuar UÇK-së?  
20 Në cilin vend? Në cilin shtet përmendët që kishit të afërm në  
21 Kosovë? A shkuat në Kosovë apo diku tjetër për t'ju bashkuar  
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për çlirimin e vendit?

23 PË. Jo, unë nga Kroacia kam udhëtu për Slloveni, në Lubjanë.  
24 Në Lubjanë jam taku edhe me disa kolegë të mi të cilët  
25 gjithashtu e kishin vendosë që t'i bashkohen Ushtrisë



1 Çlirimtare të Kosovës dhe së bashku kemi udhëtuar nga Lubjana  
2 për Tiranë, se e vetmja lidhje në afërsi aty ishte, domethënë,  
3 Lubjanë-Tiranë. Edhe kemi shku drejt e në Tiranë, domethënë,  
4 në Shqipëri.

5 PY. A udhëtoi edhe familja juaj, pjesëtarë të familjes që  
6 ishin në Kosovë apo pjesëtarë të familjes që ishin në Zvicër,  
7 a udhëtuan edhe ata me juve në Kosovë?

8 PË. Jo, jo, jo. Vetëm unë.

9 PY. Pra, përmendët që shkuat në Tiranë, a ishte ky vendi dhe  
10 momenti ku ju zyrtarisht ju bashkuat UÇK-së? A kuptoj mirë?  
11 Kështu është?

12 PË. Po në Tiranë ish si -- se e vetmja mënyrë ish me udhëtu  
13 nga Lubjana për Tiranë. Në Tiranë aty jemi taku dhe me njerëz  
14 të tjerë nga UÇK-ja dhe prej atyjit çdo gjë ka fillu edhe  
15 kyçja ime edhe e shokëve të mi që kanë qenë me mu. Jemi taku  
16 dhe me pjesëtarë të tjerë të UÇK-së, me pjesëtarë të Shtabit  
17 të Përgjithshëm edhe që nga aty ka fillue, domethënë, kyçja  
18 ime dalëngadalë në radhët e UÇK-së.

19 PY. Këtu flasim për marsin e 1999, është kështu?

20 PË. Po.

21 PY. A ju caktua juve një rol apo pozicion apo post në  
22 funksion në atë moment kur ju bashkuat?

23 PË. Po na disa ditë aty në Tiranë kemi qenë të vendosun në  
24 një, si ta quaj, banesë apo një hotel të vogël dhe kemi pritë  
25 një ekip i cila ka pasë me ardhë në mbledhjen nga Kosova,

1 domethënë nga terreni, nga vatra e luftës me planin e luftës  
2 ose të Operacionit Shigjeta. Dhe na aty i kemi prit derisa  
3 kanë ardhë ata dikun ka zgjatë gjashtë-shtatë ditë.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo  
5 ishte përgjigja ndaj pyetjes që Ju parashtruat.

6 Z. AOUINI: [Përkthim]

7 PY. Z. Dëshmitar, pas atyre gjashtë ditëve, a morët ndonjë  
8 detyrë? A ju tha dikush që të shkonit në ndonjë vend të  
9 caktuar? A u caktuat në ndonjë funksion, ndonjë rol, ndonjë  
10 pozitë bazuar në përvojën tuaj të mëparshme si ushtarak? A ka  
11 patur ndonjë organizim, a ju ka thënë dikush ku do të shkonit  
12 e ça duhet të bënit?

13 PË. Po kur është ardhë ky grupi nga Kosova, na jemi bashku të  
14 gjithë dhe jemi taku në zyrën e UÇK-së në atë kohë që e kishin  
15 në Tiranë dhe aty janë përcaktu pozicionet. Është shkru  
16 urdhëresa, besoj që ekziston dhe e keni edhe ju, është bë  
17 urdhëresa e stafit i cili ka pasë për detyrë që në atë kohë ta  
18 udhëheqë Operacionin Shigjeta.

19 PY. A shkuat në ndonjë vend tjetër nga Tirana apo qëndruat në  
20 Tiranë pas kësaj pra?

21 PË. Jo, jo. Pasi që e kemi marrë urdhëresën, komplet ekipi që  
22 ka qenë i caktuar ose komanda e cila ka qenë e caktuar për  
23 udhëheqjen e Operacionit Shigjeta, na, menjëherë, po atë ditë,  
24 kemi udhëtuar me një autobus në drejtim të veriut të  
25 Shqipërisë, domethënë, dikun në drejtim të Kukësit.

1 PY. Pra, na thatë që udhëtuat në Kukës me autobus. A jeni në  
2 gjendje të na jepni momentet kohore kur keni shkuar në Kukës?  
3 A ishte akoma muaji mars apo ndoshta disa ditë, disa javë,  
4 disa muaj më vonë?

5 PË. Jo, jo. Tek këto ka qenë disa ditë ma vonë, domethënë, ka  
6 pasë fillu muaji prill, domethënë, muaji i katërt.

7 PY. Mund të na thoni ku shkuat saktësisht në Kukës në prill  
8 të 1999 pra?

9 PË. Po në Kukës kur kemi shku, kemi shku në qendrën ku veç  
10 ishin disa pjesëtarë të UÇK-së. Në periferi të Kukësit ka qenë  
11 një uzinë. Dhe aty kemi shku dhe aty jemi vendosë.

12 PY. Pra, shkuat në Kukës në një uzinë. Dhe pyetja ime tani  
13 është në përgjithësi sa kohë qëndruat në Kukës nga ai moment  
14 në vijim?

15 PË. Po në Kukës ka qenë, si sidomos për mu dhe stafin tim,  
16 për arsye se unë në atë kohë kam qenë në bazë të urdhëresës i  
17 caktuar si udhëheqës i logjistikës. Ai ka qenë si vendqëndrim  
18 i imi dhe aty kam qëndru kohë pas kohe, por jo gjithë kohën.  
19 Ndoshta edhe kam lëvizë edhe në vende të tjera për arsye se  
20 pjesëtarët e UÇK-së nuk ka pasë vetëm në Kukës. Dhe ato, po  
21 pjesëtarë ka pasë edhe në vende të tjera, sidomos në për  
22 qendrat stërvitore që në atë kohë kanë ekzistuar.

23 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Pra, na thatë që u emëruat  
24 shef i logjistikës dhe ishit vendosur në Kukës, por nuk ishit  
25 i vendosur në mënyrë të përhershme në uzinën aty në Kukës.

1 Tani pyetja është sa shpesh dhe për çfarë arsyesh keni

2 udhëtuar në vende të tjera?

3 PË. Po fillimisht pas njoftimit me njerëzit aty që edhe kanë  
4 qenë edhe pas formimit të komandës aty pas formimit të  
5 njësiveve që është dashtë të bëhen, me një nga stafi komandues  
6 aty që kemi qenë disa ditë, kemi udhëtu nëpër qendra të  
7 ndryshme ku janë stërvitë pjesëtarët e UÇK-së. Tu fillu nga  
8 Dajti, Burreli, Kalimashi, Melshan e të gjitha ato e  
9 gjithandej ku ka pasë pjesëtarë të UÇK-së.

10 E i kemi vizitu, që na ka marrë kohë disa ditë se janë me  
11 kilometra ndoshta nuk kanë qenë shumë larg, por për shkak të  
12 rrugëve të këqija dhe rrugëve të dëmtuara. Kemi bërë ndoshta  
13 edhe disa orë, disa ditë për me shku nga një vend në vendin  
14 tjetër, se kemi dashtë që të shofim për së afërmi se ku janë  
15 ato njësi, çfarë veprojnë, si punojnë, çfarë gjendje janë të  
16 organizimeve, çfarë mbështetje të logjistikës sidomos unë atë  
17 lëmi e kam. E kam shiqu në çfarë mbështetje logjistike kanë e  
18 kështu me radhë.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Tani kthehem prapë tek pjesa e  
20 uzinës në Kukës që ju përmendët. A mund të na përshkruani  
21 shkurtimisht si dukej si ndërtesë apo si vend kjo uzina në  
22 Kukës? Na e përshkruani shkurtimisht ju lutem?

23 PË. Po sa më kujtohet, kjo ka qenë një uzinë e vjetër që  
24 është përdorë në kohën e sistemit të Enver Hoxhës. Mirëpo ka  
25 qenë e boshatisur, domethënë, nuk ka pasë -- ndoshta ka pasë

1 edhe ça gjësende të ndryshme por është pastru nga pjesëtarët e  
2 UÇK-së që t'i adaptohen kushteve tona që na janë nevojat. Dhe  
3 e kemi shfrytëzuar, domethënë, atë uzinë e cila i ka pasë disa  
4 ndërtesa. Por ato ndërtesa kanë qenë bukur të vjetra dhe jo në  
5 gjendje të mirë, por s'kemi pasë tjetër rrugëdalje përpos  
6 atyne objekteve u dashtë qato ato me i shfrytëzuar.

7 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A mund të na përshkruani  
8 shkurtimisht për ça është përdorur kjo uzinë? Në qoftë se mund  
9 ta përshkruani me pak fjalë, pra, cili është qëllimi i  
10 përdorimit të kësaj uzine?

11 PË. Po ajo uzinë i ka pasë, siç thashë edhe më parë, i ka  
12 pasë disa objekte. Ka pasë një ndërtesë që përpara është  
13 përdorë ndoshta për zyra të ndryshme dhe i ka pasë disa depo  
14 që na ato i kemi shfrytëzuar për nevojat tona çka na u kanë  
15 nevojat diçka për materiale ushtarake që të vendosen aty,  
16 diçka është përdorë edhe si fjetore, domethënë, që pjesëtarët  
17 e UÇK-së që kanë ardhur aty të bëjnë pushimin. Kjo ndërtesa e  
18 cila ka pasë disa zyra, kjo është përdorë u përdorë nga  
19 komanda janë edhe nga disa sektorë tjerë që kanë ekzistuar aty.

20 Përpos logjistikës, ka qenë edhe operativa. Operativa i  
21 ka pasë disa zyra dhe disa zyra ma të vogla ku edhe kanë bë  
22 pushimin ata njerëz që kanë punë në operativë. Edhe ka qenë  
23 një zyrë për mobilizim të pjesëtarëve të UÇK-së të cilët kanë  
24 ardhë aty që janë lajmëruar për me u kyç në UÇK.

25 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar, për këto saktësime. Do të

Dëshmitari: W04754 (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 22

1 ilustruam këtu më tej. Por, së pari, a ju kujtohet që jeni  
2 intervistuar nga kolegë tanë të ZPS-së në 2019? Ju kujtohet  
3 kjo intervistë?

4 PË. Po, po.

5 PY. Dhe a ju kujtohet t'ju jetë kërkuar që të vizitoni një  
6 skicë të uzinës në atë kohë pra?

7 PË. Po. Po, më kujtohet.

8 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar.

9 Z. AOINI: [Përkthim] Me leje të Trupit Gjykes, ndoshta  
10 mund të shfaqim në ekran këtë skicë dhe të kërkojmë pak më  
11 shumë detaje lidhur me [të] që të kemi një ide më të qartë të  
12 kuptojmë më mirë atë që dëshmitari po përshkruan lidhur me  
13 këtë uzinë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
15 që të kemi shpjegime të mëtejshme lidhur me vizatimin që  
16 dëshmitari ka bërë.

17 Znj. Sekretare, pasi të merrni numrin e ERN, a mund të  
18 shfaqni dokumentin në fjalë?

19 Z. AOINI: [Përkthim] Faleminderit, Znj. Gjykatëse. Është  
20 ERN 084525 deri në 083534 RED, në faqen 1. Dhe për versionin  
21 në anglisht është ERN 083525 deri në 083525-ET.

22 PY. Z. Dëshmitar, tani që po shikoni ekranin, a identifikoni  
23 këtë si të tuajin, pra, atë që keni vizatuar ju?

24 PË. Po, po.

25 PY. E identifikoni njëri prej nënshkrimeve në pjesën e

1 djathtë të vizatimit, si tuajin?

2 PË. Po, po.

3 PY. Z. Dëshmitar, shohim, pra, që aty janë numrat e shënuar  
4 sipas me skicë. A mund t'i merrni një nga një këto, ju lutem?

5 PË. Më falni nuk pat përkthim për atë -- a bën edhe një herë  
6 me përsërit pyetjen se nuk pat përkthim, nuk e kuptova.

7 PY. Sigurisht. Pra, z. Dëshmitar, keni skicën këtu përballë  
8 nesh. Shohim të renditur aty dhe ka një shpjegim që shoqëron  
9 secilin numër, tani ju propozoj që t'i marrim me radhë një nga  
10 një numrat me juve që të kuptojmë më saktë atë që ju keni  
11 shënuar në këtë skicë. Në rregull?

12 PË. Po.

13 PY. Pra, z. Dëshmitar, fillojmë me numrin 1. A mund të thoni  
14 çka keni shënuar aty tek numri 1?

15 PË. Po e kam shënu si hyrje, domethënë, këtu ka qenë hyrja në  
16 objekt.

17 PY. Pastaj keni numrin 2. A mund të na shpjegoni çfarë keni  
18 shkruar aty poshtë ngjit me numrin 2?

19 PË. Po. Numër 2 kjo ndërtesa në anën e djathtë nga hyrja,  
20 domethënë, kjo qenë ndërtesa e komandës.

21 PY. Z. Dëshmitar, ajo që shohim në këtë skicë që numër 2  
22 është në anën e majtë të hyrjes? A pajtoheni me mu?

23 PË. Jo, në anën e majtë. Po, pajtohem.

24 PY. Faleminderit. Donim që të ishte e qartë për transkriptin.

25 Pra, z. Dëshmitar, ky ishte numri 2. A mund të përshkruani, ju

1 thatë që ishte ndërtesa e komandës, pra, si ishte ajo nga se  
2 përbëhej?

3 PË. Kjo ishte një ndërtesë dykatëshe. Kati për dhës dhe kati i  
4 dytë. E kishte një korridor shumë, shumë, shumë të ngushtë.  
5 Këtu nën ka fillimi, domethënë, ka hymja e ndërtesës ishin  
6 shkallë të betonit dhe në katin e dytë ka qenë qendra  
7 operative. Ka qenë një, ta quaj si zyrë apo edhe se e kam  
8 përdorë edhe si fjetore, domethënë, e kam pasë aty edhe  
9 krevatin ku kam flejtë, një tavolinë. Ka qenë si zyrë edhe  
10 fjetore bashkë. Edhe disa zyra janë përdorë më shumë si  
11 fjetore të ushtarëve. Kurse në katin e parë ka qenë një zyrë  
12 apo dy, nuk e di tash s'më kujtohet, kanë qenë zyra për  
13 mobilizim që janë përdorë dhe disa tjera janë përdorë  
14 gjithashtu për pushim ose për fjetje të atyre pjesëtarëve,  
15 disa që kanë punu në ato zyra.

16 PY. Faleminderit. Pra, të kuptojmë që kjo ndërtesë, që në  
17 këtë ndërtesë ishin disa dhoma që përdorëshin si zyra, a është  
18 kështu? A ju kuptova mirë?

19 PË. Po.

20 PY. Dhe ju kishit një prej këtyre dhomave siç e përdornit si  
21 zyrë për juve ose dhe si fjetore për të fjetur?

22 PË. Po. Po.

23 PY. Z. Dëshmitar, a ishte dikush tjetër që e përdorte këtë  
24 hapësirë apo vetëm ju?

25 PË. Mendoni për atë zyrën ku unë ku kam qenë?



1 PË. Po.

2 PY. Përpos meje e kanë përdorë edhe bashkëpunëtorë të mi, të  
3 cilët kanë qenë si udhëheqës të sektorëve të ndryshëm, për  
4 arsye se logjistika i ka pasë disa sektorë: sektorin e  
5 furnizimit, sektorin e mirëmbajtjes, sektorin e transportit  
6 dhe sektorin e armatimit dhe të municionit. Dhe ata  
7 bashkëpunëtorë aty i kemi mbajtur takime të ndryshme, por disa  
8 prej tyre edhe kanë, sa kanë mujt edhe kanë pushu edhe kanë  
9 fjetur aty gjatë natës.

10 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, sa shpesh keni fjetur në këtë  
11 zyrë?

12 PË. Po s'më kujtohet, por kam fjetur por kam fjetë edhe në  
13 vende të tjera, por edhe këtu kam fjetë. Tash me thënë që  
14 brenda jave dy ditë, tri ditë ose ndonjëherë edhe më pak.  
15 Mvaret prej aktivitetit e prej punës që e kam pasë.

16 PY. Ku tjetër keni fjetë?

17 PË. Po kam fjetë kudo që e kam shku për vizitë. Domethënë, në  
18 Krumë, në Burrel, në Helçan, Kalimash, mvaret ku më ka nxënë  
19 nata, por ma së shumti, domethënë, edhe në Krumë edhe këtu në  
20 Kukës në këtë ndërtesë. Po këto kanë qenë si vendqëndrimet ma  
21 të gjata për mu.

22 PY. Z. Dëshmitar, kur keni fjetur në uzinë, a keni fjetur në  
23 ndonjë vend tjetër përveçse zyrës tuaj?

24 PË. Jo.

25 PY. Të faleminderit. Tani përmendët bashkëpunëtorët, stafi i

- 1   operativës. A e dini kush tjetër ka fjet aty në atë vende?
- 2   Nëse keni edhe emra do të ishte mirë.
- 3   PË. Po, shiqoni, këtu, ky vend ka qenë sidomos për shkak të
- 4   zyrës së mobilizimit edhe këtu kanë ardhë shumë njerëz që të
- 5   paraqiten që t'i bashkangjiten Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
- 6   Dhe ka pasë rast, për shembull, që s'ka pasë ku të flenë në
- 7   qoftë se ka qenë e zbrazët, në qoftë se ka qenë i zbrazët
- 8   krevati, atëherë ka fjet kushdo të ka pasë nevojë.
- 9   PY. Që ta kuptoj më mirë, z. Dëshmitar, përmendët persona.
- 10  Pra, nga ajo që thatë ju, kjo ndërtesë nuk ishte vetëm për
- 11  oficerë e për ushtarë që të flinin aty. Të gjithë ata që
- 12  dëshironin që kishin në mend që të mobilizoheshin në UÇK, në
- 13  qoftë se kishte vende dhe ishte ndonjë krevat bosh ata e
- 14  përdornin dhe mund të flinin aty të gjithë?
- 15  PË. Po mvaret në çfarë kohe. Ai është paraqit, në qoftë se
- 16  është paraqit ma herët, domethënë, paradite kur ju ka caktu
- 17  vendi se ku do të shkojë, ai ndoshta dhe nuk ka fjet fare aty
- 18  por ka vazdu rrugën për në ndonjë qendër stërvitore ku kanë
- 19  shku dhe ju u ka bashkangjit pjesëtarëve tjetër që të
- 20  stërvitet për punë të mëtejshme.
- 21  PY. Faleminderit. Përmendët pak më herët --
- 22       KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.
- 23  Avokat?
- 24       Z. AOUINI: [Përkthim] Po.
- 25       KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju në

1 faqen 22, rreshti 18 përmendët:

2 "... grupet e lidhura, stafi operativ, a e dini nëse e  
3 kanë kaluar natën aty? A dini ndonjë emër".

4 Mbase të veçoni edhe emrat, se deri tani morëm një  
5 përgjigje pak a shumë të përgjithshme, po mesa kuptoj unë  
6 dëshmitari i mban mend shumë mirë gjërat që kanë ndodhur aty  
7 edhe sesi. Mbase pak më shumë konkrete. Sepse më duket pak  
8 evazive këtu. kështu që nuk e di nëse e kam mirë apo jo?

9 Z. AOUINI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, do përpiqemi  
10 që t'i grupojmë sektorët dhe pastaj të hyjmë në hollësi. Unë  
11 kështu propozojmë që ta bëjmë. Që në mënyrë më konkrete do të  
12 fillojmë që tani me mobilizimin dhe më tej dhe pastaj hap pas  
13 hapi do përpiqemi të hedhim dritë mbi gjithçka që mund të më  
14 kujtohet.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Faleminderit.

17 Z. AOUINI: [Përkthim]

18 PY. Z. Dëshmitar, ju sapo cekët që aty ishin zyrat e  
19 mobilizimit, a e dini kush ishte atje brenda këtij sektori të  
20 mobilizimit, sa vetë dhe nëse mundet edhe emrat e këtyre  
21 vetëve të cilët mund të merreshin me detyrat e sektorit të  
22 mobilizimit?

23 PË. Po. Zyrat e mobilizimit kanë qenë në katin e parë dhe si,  
24 mu sa më kujtohet, që udhëheqës ose përgjegjës për ato zyra ka  
25 qenë, më duket, Xheladin Gashi. Dhe ai ka pasë disa njerëz të

1 cilët kanë punu në ato zyra.

2 PY. Pra, nuk ka qenë vetëm, kishte dhe disa të tjerë që  
3 punonin me të. Ju kujtohen emrat apo postet e këtyre tjerëve  
4 që punonin me të?

5 PË. Po ata që kanë qenë vetëm zyrtarë aty dhe kohë pas kohe  
6 dhe janë ndërru. Dhe me ju tregu të drejtën, s'më kujtohen  
7 emrat.

8 PY. A ju kujtohet nëse kanë qenë nuk e di dy vetë, dhjetë  
9 vetë, 20 vetë pak a shumë me përafërsi që të kuptojmë dhe ne  
10 sa i madh ishte ky sektor.

11 PË. 20 vetë s'kanë mujt në krejt ndërtesën se ka qenë kanë  
12 qenë zyra shumë të vogla. Në zyrë ka mujt me qenë një a dy  
13 maksimumi tre vetë. Edhe kështu. Domethënë, dy, tre zyra. S'ka  
14 pasë ma shumë.

15 PY. Tani pa u larguar nga punonjësit e mobilizimit. Këta  
16 flinin po aty, pushonin në atë ndërtesë apo diku tjetër?

17 PË. Po sa më duket, sa e di unë, disa aty. Disa edhe ndoshta  
18 shkojshin edhe dikun tjetër. Mvaret ku ka pasë vend.

19 PY. Na treguat se personat e mobilizuar vinin aty. A ju  
20 kujtohet, afërsisht, sa vetë shihnit ju çdo ditë, përditë pra,  
21 që vinin për t'u mobilizuar pranë sektorit të mobilizimit?

22 PË. Jo, ata nuk kanë qenë persona të mobilizuar. Ata kanë  
23 ardhë aty për mobilizim, për t'u mobilizuar, jo të mobilizuat.  
24 Se ata kur kanë ardhë aty, atëherë janë mobilizuar nëpërmes  
25 kësaj zyre e jo të mobilizuar se s'kanë qenë të mobilizuar.

1 A në atë kohë, për arsye se ka qenë veç urdhri nga  
2 atëherë Qeveria e Përkohshme, urdhri për mobilizim të  
3 gjithanshëm dhe këtu ka pasë njerëz një numër bukur i madh që  
4 brenda dite kanë ardhë e janë lajmëru vullnetarisht nga të  
5 gjitha anët. Ka pasë njerëz që kanë ardhë nga jashtë, ka pasë  
6 njerëz që kanë ardhë nga vetë populli për arsye se në Kukës  
7 dhe rreth Kukësit ka qenë një fluks jashtëzakonisht i madh i  
8 refugjatëve, të cilët kanë qenë të dëbuar nga forcat çetniko-  
9 serbe të Kosovës. Dhe shumë prej tyre kanë ardhë dhe janë  
10 paraqitë si vullnetarë për t'ju bashkangjitë UÇK-së në luftën  
11 kundër atyne forcave.

12 PY. Faleminderit. Ju lutem përqendrohuni tek ajo që do t'ju  
13 them. Në një numër përafërsisht sa vetë paraqiteshin çdo ditë,  
14 me aq sa ju kujtohet, pra, me aq sa keni parë? Sepse ju thatë  
15 një numër i madh, po ishin dhjetëra? Qindra në ditë?  
16 Përafërsisht.

17 PË. Po detyra ime, detyra e logjistikës dhe detyra ime ka  
18 qenë që pasi që të regjistrohen dhe ato, që na ata t'i  
19 furnizojmë me uniforma, me gjëra tjetër, me armatim dhe pas  
20 asajna ta bëjmë edhe transportin deri te qendra stërvitore.  
21 Edhe ka pasë ditë, për shembull, që ka qenë një numër më i  
22 madh, por ka pasë ditë që ka qenë numër edhe më i vogël. Por  
23 ka pasë ditë që kanë qenë deri në 100, 200 vetë që janë  
24 paraqit brenda dite.

25 PY. Faleminderit. Për të qenë të qartë, këta persona nuk

1 hynin brenda kësaj godine apo hynin brenda godinës për t'u

2 mobilizuar ndërtesën dhe godina ku ju kishit zyrën?

3 PË. Po normal që kanë pa -- s'kanë mujt me u mobilizu prej

4 rruge. Këta kanë hy brenda edhe aty janë mobilizu.

5 PY. Faleminderit. A kishte shqiptarë nga Shqipëria të cilët

6 edhe ata i kishin zyrat në atë ndërtesë, z. Dëshmitar?

7 PË. Po. Sa e di unë kanë qenë disa, por kanë qenë në sektorin

8 e operativës, sa e di unë. Por shumica prej tyre kanë qenë në

9 këto qendrat stërvitore ku kanë bë stërvitjen e pjesëtarëve të

10 UÇK-së.

11 PY. Kishte oficerë, ushtarë apo civilë shqiptarë? Mund ta

12 përcaktoni pak?

13 PË. Po ka pasë të gjitha. Të gjitha, domethënë, edhe civilë

14 edhe ushtarë të thjeshtë por ka pasë edhe oficerë.

15 PY. Ata të cilët kishin zyrat në ndërtesën numër 2 në skicë,

16 ua dini gradën, postin apo kush janë? Po të keni emra, ju

17 lutem, na i thoni dhe këto.

18 PË. Më duhet, për dy më kujtohen emrat. Ka qenë një -- ata të

19 dytë sipas të gjitha gjasave qysh kanë qenë, ku kanë qenë

20 nënkolonelë. Ka qenë një Spiro Butka edhe më duket Arqile

21 Mandro.

22 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Nëse ju kujtohet, na thoni ku

23 i kishin zyrat këta oficerët shqiptarë, domethënë, dhomat,

24 zyrat tamam --

25 PË. Në sallën --

1 PY. -- ku punonin?

2 PË. -- në sallën operative. Më fal.

3 PY. Në katin përdhes apo në katin sipër?

4 PË. Këta i kanë pasë zyrat në katin sipër, domethënë, në  
5 qendrën operative. Kanë qenë të dy të vendosur.

6 PY. Pra, ishin të vendosur aty. Aty flinin apo flinin diku  
7 gjatë nëse ju kujtohet?

8 PË. Sa më kujtohet, ata, pasi kanë qenë të Shqipërisë, ata  
9 kanë flejtë jashtë objektit. Sa më kujtohet. Ndoshta po gaboju.

10 PY. Po. Për të qenë të qartë për procesverbalin, ju përmendët  
11 gradën e z. Spiro Butka si nënkolonel, mirëpo për Arqile  
12 Mandron nuk e kemi gradën apo postin. Ju lutem, ta thoni për  
13 procesverbalin?

14 PË. Po më duket që ata kanë qenë të një grade. Sa më kujtohet  
15 mu.

16 PY. Kjo gradë bëhet fjalë që është gradë e ushtrisë shqiptare  
17 apo gradë që iu është dhënë në bazë, pra, brenda UÇK-së?

18 PË. Jo, këto kanë qenë grada të ushtrisë shqiptare.

19 PY. Z. Dëshmitar, në atë godinë, në ndërtesën numër 2, që e  
20 shohim në skicë a kishe ndonjë objekt mjekësor, ndonjë  
21 ndërtesë mjekësore apo sektor mjekësor?

22 PË. S'më kujtohet.

23 PY. A ju kujtohet që të kenë punuar në këtë ndërtesën numër  
24 2, ndërtesën e komandës, njerëz të cilët kanë pasur ose rol  
25 mjekësor apo edhe formim mjekësor?

1 PË. Më duket që kohë pas kohe e kam vërejt një mjek dhe një  
2 motër medicinale, por s'më kujtohen që kanë -- nuk kanë qenë  
3 gjithë kohën aty.

4 PY. Mos ju kujtohet emri i këtij mjekut, i ndonjë mjeku që  
5 keni parë aty në atë ndërtesë?

6 PË. Jo, jo.

7 PY. Apo emri i ndonjë motre që punonte aty në atë ndërtesë?

8 PË. Jo.

9 PY. Z. Dëshmitar, ju kujtohet një person me emrin Time  
10 Kadrie?

11 PË. Po.

12 PY. Time Kadriaj motër ishte aty? E keni parë ndonjëherë që  
13 të punonte si motër në atë ndërtesë?

14 PË. Jo, në atë kohë kur kam ardhë unë, ajo ka qenë në një  
15 vend tjetër. Mirëpo e kam taku një herë edhe aty.

16 PY. E keni takuar një herë dhe punonte si motër aty apo e  
17 keni takuar në rrethana tjera?

18 PË. Jo, në rrethana tjera.

19 PY. Faleminderit. Po një Safete Hadërgjonaj, a e njihni?

20 PË. Edhe atëherë e kam thënë edhe tash, në atë kohë nuk e kam  
21 njoftë, por vetëm pas lufte.

22 PY. Pra, a mund të konfirmoni nëse ka qenë apo jo ndonjë prej  
23 motrave që ka punuar aty?

24 PË. Po thashë se një mjek dhe një motër kohë pas kohe kanë  
25 ardhë kanë punu për nevoja në qoftë se ka pasë nevojë dikush



1 për farë mjekimi apo për diçka tjetër.

2 PY. Jo, mos ka problem përkthimi mbase. Po Safete

3 Hadërgjonaj, a ishte motër që ka punu në Kukës në godinën

4 numër 2?

5 PË. Jo, jo, s'më kujtohet.

6 PY. Cekët që aty trajtoheshit individë, pra, për të cilët

7 duheshin kujdesur, kishin nevojë për kujdes. Ju vetë me sa ju

8 kujtohet, a keni parë dikënd që të trajtohet në ndërtesën

9 numër 2?

10 PË. Jo.

11 PY. Sigurisht kohë lufte ishte të plagosur e të lënduar do

12 ketë pasur. A ju kujtohet apo dinit gjë sesi trajtoheshin të

13 lënduarit kur ktheheshin nga fronti, pra, nëse ishin të

14 lënduar qoftë edhe nga shkaqe tjera, si bëhej trajtimi i

15 këtyre personave të lënduar?

16 PË. Po çdo njësit të cilët kanë qenë në terren e kanë pasë

17 ekipin mjekësor të cilët janë kujdesë për ushtarë dhe

18 ushtarakë dhe atë ndihmën e parë, si ta them, aty për aty në

19 terren e kanë dhënë ata. Ose e kanë bërë tërheqjen, në qoftë se

20 ka qenë ndonjë lëndim më i rëndë, ndonjë plagosje më e rëndë e

21 kanë tërheq deri te spitali.

22 Që i kemi pasë dy spitale fushore. Njëri spital fushor ka

23 qenë në Kukës dhe një ka qenë në Helshan edhe i kanë tërheq

24 deri aty. Aty kanë qenë ekipe të specializuara, të cilët i

25 kanë mjeku aq sa kanë mujt. Por në qoftë se as ata s'kanë mujt

1 diçka ma shumë me bë atëherë ka qenë tërhekja e tyne deri në  
2 spitalin e qytetit të Kukësit. Dhe rastet që kanë qenë shumë  
3 të randa ka pasë herë që janë transportu edhe për Tiranë.

4 PY. Po, do t'i kthehemi më vonë kësaj. Po për hir të  
5 procesverbalit në faqen 29, e në vijim keni thënë se ishin dy  
6 spitale fushore. Njëri në Kukës. Nuk e keni fjalën për  
7 spitalin brenda uzinës?

8 PË. Jo, më falni. Në Kukës jo, po më Krumë. Në Krumë ka qenë  
9 njëri. E njëri në Helshan. Në Kukës nuk ka pasë spital fushor.  
10 Gabim.

11 PY. Pra, edhe një herë për të qenë të qartë. Brenda uzinës  
12 nuk ka pasur spital?

13 PË. Nuk ka pasur, nuk ka pasur.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.

15 Avokat, përpara se të vijoni, ju sapo folët për Time Kadrien,  
16 u përmend një rrethanë tjetër, nuk e di sesi e keni ndërmend  
17 të vazhdoni me pyetjet po besoj se kjo temë ja vlen që të  
18 eksplorohet, të shihet më tej për të mos ia lënë pastaj ZPS-së  
19 apo Trupit Gjykses.

20 [Mikrofoni çaktivizuar]. Një çast, z. Avokat. Ja jap  
21 fjalën Prokurores.

22 Prokurore, keni fjalën.

23 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, a është e  
24 mundshme që të kalojmë shkurtimisht në seancë private dhe  
25 pastaj do t'jua shpjegojë arsyen përse.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Patjetër.

3 Znj. Sekretare, ju lutem na kaloni në seancë private.

4 [Seancë private]

5 [Seancë private teksti i fshirë]

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25



Dëshmitari: W04754 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 41

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04754 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 43

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9 [Seancë e hapur]

10 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse,  
11 jemi në seancë publike tani.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit, znj. Sekretare.

14 Do të bëjmë një pushim prej gjysëm ore, do të thotë që do  
15 rikthemi, pra, do të rifillojmë në orën 12.00 pa 20 minuta.

16 Znj. Asistente, ju lutem shoqëroheni dëshmitarin që të  
17 dalë nga salla.

18 Z. Dëshmitar, do të bëjmë pushim. Pushoni pak dhe do të  
19 rifillojmë pastaj. Faleminderit.

20 DËSHMITARI: Faleminderit.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit, znj. Asistente e sallës.

24 Do të rifillojmë pas gjysëm ore.

25 --- Pauza fillon në orën 11.12

1 --- Seanca rifillon në orën 11.41

2 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini.

3 Z. Shala a më dëgjoni mirë?

4 I AKUZUARI: [përmes videolidhjes] Po, ju ndëgjoj mirë.

5 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të

6 vazhdojmë deri në orën 13.00, siç ishte parashikuar në seancën

7 e paradites punuam pak më shumë dhe tani do të jetë pak më

8 shkurt.

9 Znj. Sekretare, a mund të sillni dëshmitarin në sallë?

10 Ndërkohë do të verifikoj përbërjen e ekipeve.

11 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Nga Prokuroria, i njëjti ekip.

12 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Nuk ka përkthim]

13 Z. LAWS: [Përkthim] I njëjti.

14 Z. GILISSEN: [Përkthim] E njëjta përbërje.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se vini,

17 z. Dëshmitar.

18 DËSHMITARI: Mirë se ju gjej.

19 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat,

20 keni fjalën ju që të vazhdoni me marrjen në pyetje të z.

21 Shala.

22 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatëse.

23 PY. Mirë se vini z. Dëshmitar dhe një herë.

24 PË. Faleminderit.

25 PY. Z. Mark Shala, jemi akoma pra, në atë ndërtesën që ju e

1 përshkruat si uzinë, me ndërtesën numër 2, që ju e quajtet  
2 ndërtesa e komandës. Pra, këtu do të vazhdojmë me pyetjet  
3 lidhur me atë që ishte -- çfarë gjendej, ndodhej, brenda kësaj  
4 ndërtese numër 2.

5 Pyetja ime tani është: A e dini nëse -- a ka patur ndonjë  
6 zyrë për ndonjë departament ligjor apo ndonjë organ ligjor aty  
7 në atë ndërtesë? Bëhet fjalë për ndërtesën numër 2.

8 PË. Jo, s'më kujtohet.

9 PY. Në atë ndërtesë, a kishte ndonjë jurist, gjykatës, apo  
10 individ që keni -- kishin ndonjë rol ligjor nga ajo që dini  
11 apo që ju kujtohet?

12 PË. Jo, s'më kujtohet.

13 Z. AOUIINI: [Përkthim] Me lejen e Trupit Gjykses duam të  
14 kthehemi tek ERN 083525 deri tek 083534, dhe të kthehemi tek  
15 faqja 4 për një fotografi përpara se sa pastaj të kalojmë tek  
16 pjesët e tjera të uzinës.

17 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo është për  
18 nevoja të identifikimit, z. Avokat?

19 Z. AOUIINI: [Përkthim] Po, sigurisht.

20 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

21 Sekretare mund të na shfaqni në ekran -- besoj që e keni  
22 numrin e ERN, dhe ju lutem shfaqni në ekran faqen që është  
23 kërkuar.

24 Z. AOUIINI: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Z. Dëshmitar, e njihni këtë fotografi?

1 PË. Jo, qe aq është e shkatërrume, s'po më kujtohet.

2 Z. AOUIINI: [Përkthim] Mund -- ndoshta në qoftë se ka  
3 mundësi të kalojmë te faqja paraprake, numri 3, për të njëjtën  
4 arsye.

5 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, mund ta  
6 bëjmë këtë gjë.

7 Z. AOUIINI: [Përkthim]

8 PY. Z. Dëshmitar, e njihni këtë fotografi?

9 PË. Më duket këto si depo, depot si kanë qenë. Kjo domethënë  
10 -- tash s'po di prej cilës, po kjo ka qenë fotografia numër 1  
11 këtu, dhe këtu kënejna kuzhina edhe depo në këtë anën, në anën  
12 në vazhdim. Ashtu po më duket. Po qenka shkatërru bukur shumë,  
13 po më ka hupë fotografia.

14 PY. Do t'ju kërkojmë që të shënoni disa vende me leje të  
15 Trupit Gjykues, por ju përmendët në skicën numër 1. Aty kemi  
16 vetëm hyrjen. Tani a mund të na saktësoni kujt i referoheshit  
17 ju si hyrje apo ndërtesa 1? Që të jemi të qartë.

18 PË. Po mendoni për hyrjen? Hyrjen në ndërtesë?

19 PY. Kthehemi pak, bëjmë hap pas hapi. Përmendëm uzinën, keni  
20 bërë një skicë të uzinës kur jeni takuar me ZPS-në, dhe keni  
21 shënuar me numër disa elementë brenda kësaj uzine.

22 Tani në pyetjen time të fundit, lidhur me këtë fotografi,  
23 ju thatë ky është numri 1, ku është kuzhina dhe depoja. A mund  
24 të na thoni, ndoshta duke edhe e shënuar aty, saktësisht ku  
25 janë këto dhe ose duke vendosur një numër ose bërë një rreth,

1 ta fusni në rreth ku janë këto, kuzhina dhe depoja?

2 PË. Tash, nuk di kur është bo ky incizim, ky fotografim, por  
3 ka ndryshime në ndërtesë. Këtu sipas qysh po e shof unë këtu,  
4 këtu afër, këtu ka qenë hymja, kjo ndërtesa numër 1 këtu. Edhe  
5 kjo ndërtesa numër, numër 2, kjo kënejna. Si -- qysh po më --  
6 prej këtij këndi, po më duket se ashtu duhet me qenë.

7 PY. A keni mundësi ta shënoni hyrjen aty ku e identifikoni ju  
8 në fotografi, nëse mundeni?

9 PË. Hyrja edhe nuk po shihet, por më duket sikur hyrja duhet  
10 me qenë këtu. Hyrja nga rruga, e kam fjalën, në objekt. A  
11 hyrja në ndërtesë, po më duket se është këtu.

12 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund të  
13 shënoni hyrjen në këtë vend, nga rruga pra?

14 Dhe t'i kërkoj znj. Sekretare që të ndriçojë pak më shumë  
15 fotografinë në qoftë se është e mundur?

16 [Trupi Gjykues dhe Sekretarja e Gjykatës  
17 këshillohen]

18 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo nuk mund  
19 të bëhet, pra që të rritet kontrasti që fotografia të jetë më  
20 e qartë.

21 Z. Dëshmitar, a mund të na tregoni aty hyrjen në këtë  
22 vend? Jo hyrja në ndërtesën në veçanti, por tek gjithë vendi  
23 aty.

24 DËSHMITARI: Po.

25 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.



1 DËSHMITARI: Fotografia nuk është e qartë, dhe hyrja gati  
2 si fare nuk po -- po më duket si hyrja ish dashtë me qenë  
3 këtu.

4 Z. AOIINI: [Përkthim]

5 PY. A mund ta shënoni me numër 3 aty? Për hyrjen, hyrja pra  
6 në gjithë vendin nga rruga kur futesh nga rruga.

7 PË. Hyrja ka qenë numër 1, në bazë të asaj që kam dhanë unë  
8 përpara, por domethënë muj me shënu me 3. Por hyrjen unë fare  
9 nuk po e shof në këtë fotografi. Nuk po shifet.

10 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Është shumë e  
11 qartë kjo, por ju lutem ndiqni udhëzimet e Avokatit mbrojtës,  
12 pra që të shënohet me 3, numri 3, kështu që edhe ne e dimë  
13 pastaj që numri 3 në këtë fotografi i referohet hyrjes bazuar  
14 në dëshminë tuaj.

15 DËSHMITARI: [Shënon]

16 Z. AOIINI: [Përkthim]

17 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Pra, në qoftë se shohim këtë  
18 fotografi, fotografinë dhe numrin 1 dhe bazuar sipas dëshmisë  
19 tuaj këtu është ndërtesa e komandës. A e shihni zyrën tuaj nga  
20 këtu apo jo?

21 PË. Më duket që është kjo këtu. Kjo dritarja këtu.

22 PY. Faleminderit shumë.

23 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Propozoj, z.  
24 Avokat, që ta shënojmë me numrin 4. A mund të vendosni numrin  
25 4, z. Dëshmitar aty?

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

3 DËSHMITARI: [Shënon]

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] A duhet të shënojmë një numër edhe  
5 për hyrjen në ndërtesën e komandës?

6 PY. Ndoshta, z. Dëshmitar, mund të shënoni me numrin 5 hyrjen  
7 në ndërtesën e komandës.

8 PË. [Shënon]

9 PY. Faleminderit. Tani kalojmë tek ajo që ju shënuat me  
10 numrin 2. A mund të na thuani çfarë është kjo?

11 PË. Këtu gjysma e kësaj ndërtese këtu ka qenë kuzhinë. Kjo,  
12 kjo këtu, edhe kjo këtu. Këtu si më duket ka qenë një depo e  
13 ushqimit. E kënejn, këtu kënej ka qenë depo e armatimit. Edhe  
14 disa gjana të tjera që neve na u kanë nevojë si logjistikë.  
15 Pjesë rezervë.

16 PY. A mund të shënoni shkronjën K për atë që mendoni që është  
17 kuzhina, dhe F ku ishte -- ku mbahej ushqimi?

18 PË. Si, F? Ef?

19 PY. F, si *food* në anglisht, që është ushqimi.

20 PË. [Shënon]

21 PY. Tani z. Dëshmitar, ju përmendët edhe vendin ku ruhej  
22 uniformat apo pajisjet, nuk -- nëse shihni në fotografitë këtë  
23 pjesë mund ta shënoni me shkronjën U?

24 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Prisni një  
25 sekondë, z. Dëshmitar.

1 "Këtu ishte depoja e armëve ku kemi mbajtur edhe gjëra të  
2 tjera që na duheshin, na nevojiteshin si pjesë e logjistikës."

3 Ndoshta nuk -- ka ndonjë gjë që s'e kam kuptuar unë.

4 DËSHMITARI: Ashtu.

5 Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk e lexova nga transkripti, por e  
6 saktë që përmenden vetëm armë.

7 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, z.  
8 Avokat.

9 Z. AOUINI: [Përkthim]

10 PY. Pra mund të shënoni ndoshta me W vendin që, sipas jush,  
11 ajo që mendoni ju, aty ku ruheshin armët, pra.

12 PË. [Shënon]

13 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Atëherë, të fillojmë me  
14 kuzhinën. E dini kush punonte në kuzhinë, a keni ndonjë emër?  
15 Apo cila pjesë, seksion, departament?

16 PË. Po ka qenë një komandant i një kompanie për furnizim, ku  
17 e ka pasë, i ka pasë edhe disa kuzhinierë edhe njerëz të tjerë  
18 që kanë -- njerëz ndihmës që kanë ndihmu në përgatitjen edhe  
19 ndarjen e ushqimit. Këtu dikund, kjo e para këtu është  
20 përgatitë, kurse në këtë pjesën e kënejnës, po në këtë pjesën e  
21 djathtë është bërë ndarja -- e ushqimit.

22 PY. Na thatë që ishte një komandant kompanie aty. A keni  
23 ndonjë emër?

24 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat,  
25 duhesh dhënë një numër apo shkronjë shtesë. Por, kam frikë që

1 pastaj kur ta lexojmë nuk do të jetë e qartë. Pjesa pra, ku  
2 përgatitej dhe shpërndahej ushqimi.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Shumë mirë, znj. Gjykatëse.

4 PY. Z. Dëshmitar, a mund të shënoni me K1, aty ku përgatitej  
5 ushqimi dhe K2 aty ku shpërndahej ushqimi?

6 PË. [Shënon]

7 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit,  
8 z. Avokat.

9 Z. AOUINI: [Përkthim]

10 PY. Që t'i kthehem pyetjes. Përmendët komandantin e  
11 kompanisë. A keni ndonjë emër të personave që punonin në  
12 pjesën e kuzhinës, pra?

13 PË. Me emra, nuk më kujtohen. Ekzistojnë listat, por unë nuk  
14 e kam, të cilët kanë qenë dhe kanë punu në atë. Por njerëz që  
15 komandant që ka qenë, e ka pasë mbiemrin Fejzullahu.

16 PY. A njihni një person me emrin Zejnullahu, mbiemrin?

17 PË. Thashë Zejnullahu, edhe unë e thashë.

18 PY. Pra, është Zejnullahu, jo Fejzullahu? Që të jetë e qartë  
19 për procesverbal?

20 PË. Fejzullahu, Fejzullahu.

21 PY. Faleminderit.

22 PË. Tash saktësisht s'po më kujtohet.

23 PY. E kuptojmë z. Dëshmitar. Tani shikojmë shkronjën F. E  
24 dini kush punonte në këtë departament, kush ishte përgjegjës  
25 për ushqimin, a keni ndonjë emër?

1 PË. Po gjithë këta që kanë bo përgatitjen, këta kanë bo edhe  
2 shpërndarjen. Domethënë edhe shpërndarjen e ushqimit, çdo gja,  
3 ata e kanë kry. Edhe punët ndihmëse dhe ato kryesore. Të  
4 njëjtit njerëz.

5 PY. Tani, pjesa që kemi shënu me W për armët. Edhe këtu e  
6 njëjta pyetje: A e dini kush ka marrë pjesë apo kush ka qenë  
7 përgjegjës për këtë pjesë në qoftë se keni ndonjë emër?

8 PË. Këto të dyja këtu, njëra ka qenë ku është për -- si vend  
9 ku është bo mirëmbajtja e armatimit. Kurse në këto dy këtejna  
10 është bo ruajtja e armatimit edhe e një pjese të municionit,  
11 atë çka ka pasë.

12 PY. A mund të shënoni me W1, W2 në qoftë se ka ndonjë ndarje  
13 pra, veçim? Duke thënë konkretisht cila është W1 dhe cila  
14 është W2, për procesverbal pra?

15 PË. Këtu ka qenë vendi ku është mirëmbajtë, me W1. W2 ku  
16 është bo deponimi i armatimit ose që ka qenë me -- domethënë  
17 nuk ka qenë në rregull, dhe armatimi që është -- që kanë  
18 rregullu këta njerëzit që kanë punu në këtë W1.

19 PY. Faleminderit. Nuk ju kujtohet asnjë emër i personave që  
20 kanë punuar në këtë pjesë, në këtë seksion?

21 PË. Po për mirëmbajtjen, ato të armatimit ka qenë Zijadin  
22 Hoxha.

23 PY. Kjo ka të bëjë me W1, bazuar në atë përshkrimin tuaj, apo  
24 jo?

25 PË. Po, edhe kjo tjetra ka qenë në kompetencat e tijna.

1 PY. Faleminderit shumë. Më vonë, në një pjesë tjetër do të  
2 trajtojmë çështjen e emrave në përgjithësi. Por faleminderit  
3 për këtë.

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Tani, në qoftë se mund të kthehemi  
5 tek -- natyrisht paraprakisht duhet që të ruajmë këtë dokument  
6 me shënimet e bëra.

7 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
8 Sekretare, a mund ta ruani këtë dokument dhe t'i caktoni pra,  
9 bëhet fjalë për fotografinë bashkë me shënimet e bëra gjatë  
10 marrjes në pyetje të dëshmitarit nga Mbrojtja? Ju lutemi jepni  
11 një numër këtij dokumenti.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Shënimet e bëra nga  
13 dëshmitari W04754 në dokumentin me numrin ERN 083527, do t'i  
14 jepet numri REG00974.

15 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit,  
16 znj. Sekretare.

17 Z. Avokat, keni fjalën.

18 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse. Me  
19 lejen tuaj do të kthehemi tek faqja 1 që të rendisim shënimet  
20 dhe numrat e përdorur, dhe pastaj do kaloj te një pjesë tjetër  
21 që nuk paraqitej në këtë fotografi.

22 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kur flisni  
23 për faqen numër 1, e keni fjalën për skicën?

24 Znj. Sekretare, ju lutem, ngarkoni skicën e përgatitur  
25 nga dëshmitari që u shfaq më herët. Faleminderit.

1 Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se s'ka kundërshtime, do  
2 të përpiqem që të bëj një përputhje të numrave që u shënuan në  
3 fotografi, me numrat që paraqiten në këtë skicë dhe t'i kërkoj  
4 dëshmitarit që të konfirmojë këtë gjë.

5 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Propozoj që  
6 të heqim faqen -- pjesën e majtë, pjesën në anën e majtë dhe  
7 të vendosim në vend të saj fotografinë e fundit që ruajtëm dhe  
8 që përmban numrat në shënim me qëllim që të mos detyrohemi t'i  
9 kujtojmë ato numra, por ta kemi përballë.

10 Znj. Sekretare, jeni në gjendje të na bëni këtë?  
11 Faleminderit.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Besoj që s'mund ta zmadhojmë më  
13 shumë.

14 PY. A jeni në gjendje të identifikoni numrat që ju z.  
15 Dëshmitar, shënuat në fotografinë që është në anën e majtë të  
16 ekranit, me qëllim që të identifikojmë. A i shihni numrat, a  
17 mund t'i dalloni?

18 PË. Po, po.

19 PY. Atëherë, në qoftë se ju kuptojmë siç duhet, cili është  
20 numri 3 që ju e shënuat në fotografi, tani kur shohim skicën?  
21 Ky numri 3 në fotografi, me cilin numër përputhet në skicë, në  
22 qoftë se përputhet me ndonjë?

23 PË. Me numrin 1.

24 PY. Tani, numri 1, 4 dhe 5 të cilët janë në të njëjtën  
25 ndërtesë, këto tre numra përputhen me ndonjërin prej numrave

1 që keni shënuar në skicë?

2 PË. 1, 4 dhe 5?

3 PY. Po.

4 PË. Me këtë skicën përputhet vetën numri 2 dhe numri 3.

5 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo...

6 Z. AOINI: [Përkthim]

7 PY. Numri 3 në skicë mban titullin "kuzhina" dhe "depoja", në  
8 skicë. Tani në qoftë se shohim fotografinë, kemi --

9 PË. Po.

10 PY. Pra, numri 3 kuzhina dhe depoja, a po na thuani që kjo  
11 përputhet me numër 1, 4 dhe 5 në fotografi?

12 PË. Jo, me 1, 4 dhe 5 jo. Vetëm përputhet me numrin 2 dhe 3.

13 Mirëpo këtu nuk ka qenë te skica të cilën unë e kam vizatu

14 unë. Nuk ka qenë detaje sikur edhe nuk -- në këtë fotografi

15 unë veç që e kam shënu si kuzhinë edhe depo. Por nuk e kam

16 saktësu bash në cilin vend ka qenë kuzhina ku është përgatitë

17 ushqim dhe ku është bë ndarja e ushqimit. Këto kanë qenë dhe i

18 kanë dy dyert të mëdhaja, mirëpo si me rëndësi ka qenë një

19 depo.

20 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të

21 vazhdoni --

22 Dëgjoni, z. Dëshmitar, numri 3 në skicën tuaj?

23 DËSHMITARI: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani, a e

25 kuptoj mirë unë që ky numër përputhet me ndërtesën ku keni



1 vënë dy shkronjat K dhe F, dhe W-të. A përputhet me këtë? Dhe  
2 sipër tyre është numri 2?

3 DËSHMITARI: Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, numri 3  
5 në skicë përputhet me ndërtesën numër 2 në fotografi? E pashë  
6 që lëvize kokën në shenjë pohuese dhe që the "po".

7 DËSHMITARI: Po.

8 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, ju  
9 e keni fjalën tani.

10 Z. AOINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

11 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani le të përqendrohemi tek  
12 skica, sepse këtu kemi edhe numra të tjerë për pjesë të tjera  
13 të këtyre, të këtij vendi, për të cilat duam t'ju bëjmë  
14 pyetje.

15 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, na  
16 duhet akoma fotografia që është në anën e majtë të ekranit.

17 Z. AOINI: [Përkthim] Jo, nuk kemi nevojë se --

18 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë, znj.  
19 Sekretare, në qoftë se mund ta hiqni nga ekranin fotografinë në  
20 anën e majtë me qëllim që të zmadhojmë skicën. Faleminderit.

21 Z. AOINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

22 PY. Atëherë, z. Dëshmitar, tani në skicë kemi numrin 4 që  
23 është në anën e kundërt të hyrjes numër 1. A mund të na thuani  
24 për çfarë përfaqëson ky numër 4, pra?

25 PË. Numri 4 është, ka qenë krejtësisht depo në të cilën ka

1 pasë pajisje të përziera. Në njëërën anë ka qenë, tash nuk më  
2 kujtohet a në anën e majtë a në të djathtë prej hyrjes, se e  
3 ka pasë vetëm një hyrje më duket. Në njëërën anë kanë qenë  
4 uniforma dhe disa pajisje të tjera si tenda, thasë të fjetjes,  
5 batanija, asi, kurse në anën e djathtë si duket ka qenë --  
6 kanë qenë artikuj ushqimorë.

7 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A e dini kush ka punuar në  
8 këtë depon numër 4?

9 PË. Po kanë punu shumë, shumë njerëz që ka pasë domethënë  
10 ndërrime kohë pas kohe. Por saktësisht me emër s'po më  
11 kujtohet. Rexhep --

12 PY. Nuk ju kujtohet?

13 PË. Po më duket se Rexhep Kelmendi, sa më duket, ka qenë si  
14 përgjegjësi kryesor për furnizim.

15 PY. Faleminderit. Ju kujtohet ndonjë emër tjetër?

16 PË. Për momentin, jo.

17 PY. Kalojmë tani, jemi akoma tek skica pra, kalojmë tek numri  
18 5. A mund të na thuani çka ishte kjo ndërtesa që është shënuar  
19 me numër 5?

20 PË. Këtu ka qenë si një lloj fjetore, për ata pjesëtarë të  
21 cilët kanë ardhë, që janë lajmëru për mobilizim, dhe disa që  
22 s'kanë mujtë me u transportu atje ku është dashtë. Atëherë e  
23 kanë ba natën aty, kanë fjetur derisa e kemi bo transportin e  
24 qendrës stërvitore.

25 PY. E keni fjalën këtu për civilë apo për ushtarë, apo edhe

1 civilë edhe ushtarë, në këtë rast?

2 PË. Jo, ata që kanë ardhë me u bo ushtarë. Për disa kanë qenë  
3 të uniformumë, e disa kanë qenë edhe me tesha civile deri sa i  
4 kanë marrë uniformat.

5 PY. Shumë e qartë. Pra, personat që do të mobilizoheshin. A  
6 keni ndonjë ide sa vetë flinin aty në një moment të caktuar,  
7 nga ajo që keni parë ju vetë?

8 PË. Po nuk kanë qenë -- edhe kushtet jo të mira. Mirëpo aty  
9 kanë mujtë maksimalisht deri njëqind vetë, jo ma shumë.

10 PY. A hytë ju vetë? Keni hy ju vetë në atë ndërtesë, keni  
11 fjetë ju vetë ndonjëherë aty?

12 PË. Me fjetë s'kam fjetë, me hy kam hy.

13 PY. Brendia e asaj godine si ishte, nëse mund të na e  
14 përshkruani?

15 PË. Por shumë pak ka pasë krevate. Por ma shumë ka pasë të  
16 shtruara në dysheme. Edhe ka pasë disa dyshekë, e ka pasë  
17 thasë të fjetjes, ka qenë ushtarët i kanë -- për fjetjen në  
18 terren. Ndonji batani, ndonji jastëk edhe kryesisht kështu ka  
19 qenë.

20 PY. Kalojmë tani tek numri 6, që është numri i fundit i  
21 shënimeve që i keni bërë skicës. Çfarë ka qenë numri 6?

22 PË. Po këtu është e vizatime kjo skica kështu pak si ma --  
23 duket si me qenë afër, por kjo ka qenë pak ma larg. Këtu kanë  
24 qenë tualetet, disa tualete ashtu me thanë si tualete fushore,  
25 aty.

1 PY. Keni përdorur ju ndonjë prej këtyre tualeteve fushore?

2 PË. Po ndonjëherë rrallëherë, por po kur kam pasë nevojë të  
3 shpejtë, po.

4 PY. Më falni për pyetjen, por nëse kishit nevojë -- nëse ju  
5 duhet me kry nevojat, ku tjetër shkonit për t'i kryer, përveç  
6 këtyre tualeteve fushore?

7 PË. Po unë i kam pasë disa probleme shëndetësore, edhe kam  
8 pasë nevojë për një pastrim ma të mirë me e pasë. Kam përdorë  
9 edhe tualete të tjera, ose ndonji lokal jashtë apo edhe ndonjë  
10 banesë të ndonji prej, të ndonji njeri i njoftun që e kam  
11 njoftë aty, në afërsi. Kështu që kam shku edhe atje.

12 PY. Faleminderit. Duke lënë mënjanë këto tualetet që  
13 ndodheshin nëpër banesa jashtë, domethënë, jashtë këtyre,  
14 jashtë objektit, ju cekët tualetet e tjera. Këto tualete të  
15 tjera ndodheshin brenda mjediseve të objektit, në ndonjë vend  
16 tjetër aty?

17 PË. Jo, jo. Jashtë, jashtë. Jashtë objektit. Këto domethënë  
18 përbrenda objektit kanë qenë vetëm këto tualete. S'ka pasë të  
19 tjera tualete.

20 PY. Këto tualete nuk ishin vetëm për ushtarët, jo vetëm për  
21 rekrutët e sapomobilizuar, por ishin tualete të përgjithshme  
22 të cilat i përdornin të gjithë ata që ndodheshin në objekt,  
23 apo nuk, ishte kështu?

24 PË. Për të gjithë ata që kanë qenë te objekti i kanë përdorë  
25 këto tualete. Sa kanë qenë aty.

1 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat, ju  
2 lutem, bëni një pyetje sqaruese lidhur me termin tualet  
3 fushor, se mund të ketë kuptime të ndryshme.

4 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

5 PY. Z. Dëshmitar, ju cekët fjalën tualete fushore që për ne  
6 nuk është shumë e qartë. Ku dallon tualeti fushor nga ajo që  
7 gjithkush do ta kuptonte si një tualet normal? Nëse mund të na  
8 e përshkruani për ta kuptuar pakëz më mirë.

9 PË. Po tualet, tash me jua -- tualet normal është që të, ku  
10 janë tualetet brendapërbrenda një objekti, dhe i kanë të  
11 gjitha kushtet për ta kry ndonjë nevojë. Ku ka ujë, mbase këto  
12 kanë qenë tualete të ndërtuara vetëm prej tullave. Dhe bile  
13 shumë prej tyre s'kanë pas as dyer, por kanë qenë të hapura.  
14 Edhe për atë arsye në njëfarë mënyre edhe të ndara prej  
15 objekteve, domethënë, këto kanë, ky si objekt ka qenë i ndarë  
16 prej këtyre objekteve të tjera.

17 Edhe ka qenë një -- disa gropa, disa dërrasa, dhe është  
18 aty është, ashtu është, ashtu ka funksionu. Domethënë nuk ka  
19 pasë as ujë, as... Kanë qenë kushte jashtëzakonisht të  
20 vështira.

21 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

22 Më lejoni një pyetje. Z. Dëshmitar, në ekran, në skicën  
23 që ju e keni vizatuar, madhësia pra, përmasat e këtij objektit  
24 ku ndodheshin tualetet, sa ishin, pra ç'përmasa kishte? Se  
25 duket, ngjan kështu sikur godina ku ndodheshin tualetet është

1 veç pak më e vogël sesa fjetorja, pra, aty-aty.

2 DËSHMITARI: Jo, këtu është puna te si qysh e kam vizatu  
3 unë për me e tregu, se këtu kanë qenë tualetet. Se jo,  
4 tualetet kanë qenë shumë të vogla. Është puna te vizatimi,  
5 domethënë është puna që kanë qenë, janë sa për shembull janë  
6 sa kjo depo poshtë, nuk është sa një e dhjeta e këtij objekti.

7 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit,  
8 e qartë.

9 Z. Avokat, keni fjalën.

10 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.  
11 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar për përpjekjet për të sqaruar.

12 Z. AOIINI: [Përkthim] Dëshirojmë t'i kthehemi tani një  
13 tjetër faqeje me lejen e të nderuarve Gjykatës. Ku ka një  
14 tjetër fotografi me të njëjtin numër të provës ERN, sepse  
15 dëshmitari ka shënuar disa numra për të bërë një përputhje me  
16 numrat.

17 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, mundet të  
18 vazhdoni.

19 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit. Është faqja me numër  
20 2 i të njëjtit dokument.

21 E nderuar Gjykatëse, mbase mund të vendosim skicën nga  
22 njëra anë dhe këtë fotografi nga ana tjetër për të bërë  
23 përputhjen e numrave.

24 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëherë në  
25 anën e majtë shohim numrin 2, në mes numrin 4 dhe djathtas

1 shohim numrin 5. Dhe poshtë është dhe një numër 1 nëse nuk e  
2 kam gabim.

3 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, keni të  
4 drejtë. Është numri 1 i vendosur poshtë portës.

5 Z. AOUBINI: [Përkthim] Jo, na duhet skica, jo fotografia.  
6 Faleminderit.

7 PY. Z. Dëshmitar, mund të jetë më e thjeshtë tani. Keni  
8 numrat që keni shënuar në skicë, dhe numrat këtu në këto  
9 fotografi që i keni shënuar në intervistën që i keni dhënë  
10 kolegëve të ZPS-së.

11 Pyetja ime është kjo: Të njëjtët numra që janë në skicë  
12 janë të njëjtët numra që janë në fotografi apo nuk përputhen  
13 këta numra?

14 PË. Plotësisht përputhen. Numri 1 është numri te kjo ku kam  
15 vizatu unë, hymja. Kjo këtu. Numri 2 është kjo. Numri 4 është  
16 kjo. Edhe numri 5 kjo këtu.

17 Por që numri 4 i bjen sikur të ishte kjo hymja, por jo,  
18 kjo tregon atë depon atje lart ku shihet.

19 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
20 vazhdoni? Së pari, a mund ta ruajmë këtë dokument? Po përpara  
21 se ta ruajmë, kam një pyetje shtesë. Ka Trupi Gjykses një  
22 pyetje shtesë.

23 Në fotografinë që sapo e nxorët në ekran, z. Avokat, ka  
24 diçka që nuk e shoh në skicë.

25 Z. Dëshmitar, në të majtë të fotografisë --

1 DËSHMITARI: Po.

2 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- përpara  
3 godinës që e keni shënuar me numrin 2, ka një godinë më të  
4 ulët me çati të sheshtë, pra tarracë. Dhe duken sikur ka dy  
5 dyer. A e dini, a po e kuptoni njëherë se për çfarë e kam  
6 fjalën?

7 DËSHMITARI: Po, po. Për këto këtu.

8 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shënojeni me  
9 numrin 7, ju lutem.

10 DËSHMITARI: [Shënon]

11 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e dini se  
12 ç'funksion e ka pasë ajo godinë?

13 DËSHMITARI: Këtu kanë qëndru rojet, të cilët kanë bo roje  
14 në këtë hyrjen këtu.

15 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po për ndonjë  
16 funksion tjetër, me sa dini ju, përdorej?

17 DËSHMITARI: Jo, përpos roje. Roja këtu e ka hapë, ka  
18 mbyllë. Kush ka dalë jashtë i kanë kontrollu automjetin,  
19 dokumentin, e kështu me radhë.

20 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit,  
21 z. Dëshmitar.

22 Z. Avokat, keni fjalën. Një moment, një moment që ju  
23 ngrita në këmbë, dhe duhet të uleni prapë. Por në fillim duhet  
24 që t'i ruajmë këto dy dokumente dhe t'u caktojmë një numër.

25 Znj. Sekretare, ju lutem veproni. Faleminderit.



Dëshmitari: W04754 (Seancë e hapur)  
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 65

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
2 shënimet e bëra nga dëshmitari 04754 në dokumentin numër ERN  
3 083525 do të marrin numrin e zyrës administrative REG00975.

4 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.  
5 Keni fjalën, z. Avokat.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Një pyetje e fundit lidhur me këtë para se të kalojmë në  
8 një temë tjetër, dhe ju lutem të tregoni kujdes. Na thatë se  
9 godina numër 7 ishte vendi ku qëndronin rojet, që bënë roje,  
10 rojat. Dhe thjesht përgjigjuni me "po" ose "jo", sepse pastaj  
11 varet a do kalojmë në seancë private. Pra vetëm "po" ose "jo".  
12 A dini emrin e ndonjë prej rojave që punonin, që qëndronin tek  
13 godina me numër 7? Dhe përgjigjuni vetëm me "po" ose me "jo".

14 PË. Jo.

15 PY. Në rregull, është e qartë. Faleminderit shumë.

16 Z. Dëshmitar, do të kalojmë tani te një temë tjetër. Që  
17 ka të bëjë me Pjetër Shalën. Emrin Pjetër Shala a e njihni?

18 PË. Po.

19 Z. AOUBINI: [Përkthim] Mund t'i heqim fotografitë nga  
20 ekrani, sigurisht.

21 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit,  
22 znj. Sekretare.

23 Z. AOUBINI: [Përkthim]

24 PY. Z. Dëshmitar, ju quheni Mark Shala vetë. Pra keni të  
25 njëjtin mbiemër, ose të ngjashëm sepse e dimë që ndonjëherë

1 jua shkruajnë mbiemrin edhe Shalaj, por a keni ndonjë  
2 marrëdhënie familjare, pra jeni farefis me z. Pjetër Shala?  
3 PË. Po nuk kemi marrëdhënie të afërta familjare, por tek ne  
4 shqiptarët farefisi shkon shumë, shumë larg, shumë gjatë. Edhe  
5 unë edhe në bazë të thënunave të baballarëve dhe të gjyshit  
6 tim, kurrkush nuk e mban mend që të kemi qenë një bashkësi,  
7 por të fisit, te ne si quhet, jemi të një fisi.

8 PY. Ju dëgjuam që përmendët fjalën fis. A mund ta shpjegoni  
9 ngadalë sepse nuk u kap plotësisht në përkthim se çfarë do të  
10 thotë kjo?

11 PË. Po ne në traditë i kemi, shqiptarët të ndamë në fise,  
12 fise të ndryshme që edhe sot i kultivojmë ato. Ka për shembull  
13 fisi Shala, fisi Gash, Kastrat, e fise të tjera. Dhe ndoshta  
14 në kohët e lashta kemi qenë në një bashkësi, por nuk e mbajmë  
15 mend asnjë prej atyne ma të vjetërve, se kur ka qenë ajo kohë  
16 ndoshta para 200, 250 viteve, 300. Kush e mban mend aq gjatë?

17 Mirëpo, marrëdhëniet mes familjeve janë mbajtur me kohë.  
18 Familja e Pjetrit, baba, nana, vëllau, ai vetë, sa ka qenë si  
19 fëmijë, kanë ardhë ndonjëherë te na. Familja jonë kanë shku,  
20 për arsye edhe s'kemi jetu në një vend. Ne kemi jetu në  
21 Gurakoc, komuna e Istogut, kurse ata një kohë kanë jetu në  
22 rrethinë të Gjakovës, e pastaj në Prizren.

23 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Do hapim një kllapë për  
24 momentin, sepse përmende Gjakovën.

25 Z. Dëshmitar, a keni qenë ndonjëherë në Gjakovë apo

1 Ratkoc përpara apo gjatë luftës? Kurdo qoftë kjo gjatë jetës  
2 suaj.

3 PË. Në Gjakovë? Po gati ma shumë se në vendlindje se  
4 bashkëshorten e kam të Gjakovës, jam dhëndri i Gjakovës,  
5 atëherë kam shku shpesh.

6 PY. Ratkoc, Sergjen, a keni ndonjë lidhje atje?

7 PË. Jo, jo. Vetëm në Gjakovë, bash në Gjakovë e kam,  
8 domethënë familjen e bashkëshortes i kam bash në Gjakovë, në  
9 qytetin e Gjakovës. A të njohur, i kam gjithë ato vendet në  
10 rreth të Gjakovës, Ratkoc, e vende të tjera.

11 PY. Faleminderit shumë, kjo është e qartë. Tani kthehemi te  
12 Pjetër Shala. Prej kur e njihni apo e keni njohur Pjetër  
13 Shalën?

14 PË. Tash me thanë kur ka qenë si fëmijë, se unë jam disa vite  
15 ma i vjetër se ai, dhe më kujtohet kur ka ardhë me babain, me  
16 nanën e tijna tek ne. Por e mbaj mend edhe na kemi shku te ata  
17 në Prizren. Dhe e mbaj mend si fëmijë.

18 PY. Ju kujtohet si fëmijë, e mbani mend si fëmijë, por në  
19 moshë të rritur, kur keni qenë të rritur, a mund të na thoni  
20 çfarë lloj marrëdhënie keni pasë me Pjetër Shalën, a keni pasë  
21 marrëdhënie, keni pasë lidhje, a keni qenë të afërt a jo? A,  
22 si janë zhvillu këto marrëdhënie, a mund të na e përshkruani  
23 pak?

24 PË. Marrëdhëniet kanë qenë ashtu familjare kur kemi pasë  
25 ndonji aheng, ose ndonji festë familjare, kemi shku te njëri-

1 tjetri. Por, unë mbas shkollës së mesme, unë e kam vazhdu, kam  
2 shku në akademinë ushtarake. Dhe prej asaj kohe, domethënë,  
3 prej vitit 1980, ai nuk di, është dikund -- nuk di çfarë  
4 datëlindje është -- mirëpo që nga viti 1980 e mbrapa e kam pa  
5 shumë pak, ose hiç, për arsye se s'na ka ra me u takue. Unë  
6 kam qenë jashtë vendlindjes, jashtë Kosovës. Nji herë në  
7 akademi, masandej në shërbim ushtarak. Masandej edhe në luftën  
8 e Kroacisë, edhe në ushtrinë e Kroacisë deri në ardhjen në --  
9 kyçja ime në UÇK.

10 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Dhe marrim këtë moment kohor.  
11 Pra, prill, mars ose prill 1999, kur i jeni bashkangjitur  
12 luftës. Në këtë moment, në mars 1999, kur është hera e fundit  
13 që e ke pa -- që keni parë Pjetër Shalën? Përpara kësaj  
14 periudhe, pra përpara luftës.

15 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra, pyetja  
16 është: Përpara se t'i bashkoheshit UÇK-së, cila ka qenë hera e  
17 fundit që e keni pa Pjetër Shalën, përpara që ju me iu bashku  
18 UÇK-së?

19 PË. Po me të tregu të drejtën, s'më kujtohet veç mundet me  
20 qenë dikun në vitet, para viteve 1980.

21 Z. AOIINI: [Përkthim]

22 PY. Faleminderit. Tani, a jeni taku ndonjëherë me Pjetër  
23 Shalën gjatë luftës?

24 PË. Gjatë luftës jam takue dy herë.

25 PY. A mund të na ndihmoni kur dhe ku e keni taku? Sepse

1 përmendët, thatë, dy herë, do t'i marrim secilën me radhë. Por  
2 në mënyrë shkurt, kur dhe ku e keni taku, apo pa, atë këto dy  
3 herë?

4 PË. Hera e parë ka qenë kur ne kemi ardhë në Kukës, dhe është  
5 jemi vendosë aty. Edhe ai një kohë sipas informatave që kam  
6 pasë, ka qenë në qendër stërvitore në Burrel, pastaj ka ardhë  
7 në Kukës. Edhe unë në Kukës. Ai ka qenë në Kukës, unë kur kam  
8 ardhë ai ka qenë aty. Edhe, jemi taku një ditë. Saktësisht  
9 datën nuk e di, veç e di që ka qenë dikund në fillim të  
10 prillit.

11 PY. Faleminderit. Pra, tani ju përmendët këtu herën e parë që  
12 je taku me të, saktë?

13 PË. Po.

14 PY. Na thatë që e takuat në Kukës. A mund konkretisht, uzina,  
15 qyteti, zona, rajoni, ku pak më konkretisht, ku e keni taku  
16 Pjetër Shalën herën e parë?

17 PË. Pjetrin e kam taku konkretisht në uzinë, ka ardhë. Për  
18 arsye se ai ka qenë në një objekt tjetër, aty afër dikund në  
19 periferi të Kukësit. Edhe ka ardhë për t'u taku me mu. Edhe  
20 jemi taku, kemi bisedu e kemi pi nga një kafe.

21 PY. Sa zgjati ky takim?

22 PË. Po nuk besoj që ka zgjatë ma shumë se gjysmë ore.

23 PY. Çfarë ndodhi gjatë këtij takimi, për çfarë u bisedua,  
24 çfarë ishte përmbajtja e bisedës nëse mund të na thoni?

25 PË. Ai në atë kohë ka qenë, ju thashë, ka qenë i vendosur në

1   nji objekt tjetër, edhe bisedumë në lidhje me rrjedhat, se çka  
2   do të ndodhë, çka do të bohet, edhe ai ishte për arsye se në  
3   atë kohë nuk di sa ka -- kur është kthy, por edhe ai është  
4   kthy nga Perëndimi se ka qenë edhe ai më duket në Belgjikë, te  
5   familja e vet, edhe ka ardhë përsëri në luftë në Kosovë.

6           E di që më ka thanë që po ai e ka mendjen që të shkojë në  
7   vijë të parë të frontit, e mu ka lutë "Në qoftë se mundesh, ke  
8   mundësi që të ma sigurosh një armë edhe unë do të shkoj. Nuk e  
9   kam mendjen me u kthy pa u kry ky proces, kjo luftë". Edhe  
10   gati me aq ka qenë. Ia kemi, ia kam sigurue armën dhe ai ka  
11   marrë rrugën për vijë të parë të frontit.

12   PY.   Dy-tre sqarime këtu. Ju thatë që ai rrinte në një vend  
13   tjetër, apo ndryshe a mund të -- jashtë Kukësit. A mund të na  
14   thuani çfarë dini ju ku ka qenë ai, ku ka qëndruar tamam?

15   PË.   Po ka qenë dikund në një rrugë tjetër, jo në këtë rrugën  
16   që e kemi pasë në Kukës, në drejtim të Krumës, por ka qenë një  
17   rrugicë tjetër. Ka qenë në një si t'ju them ashtu, një shtëpi  
18   ku kanë qenë disa, edhe aty ka qenë një grup i pjesëtarëve të  
19   UÇK-së, e me atë grup ka qenë edhe Pjetri.

20   PY.   Pra, nuk ka qenë brenda uzinës, apo jo?

21   PË.   Jo, nuk ka qenë.

22   PY.   Ju kujtohet çfarë arme i sigurove Pjetër Shalës, ia dhe?

23   PË.   Më duket se e ka lypë një të tipit snajper, më duket se  
24   atë armë e ka. E ka nënshkru një -- unë e kam dhanë urdhën një  
25   oficeri që ka qenë i ngarkumë me ato punë, e ka nënshkru

1 vërtetimin, numrin e armës, ka marrë armën edhe ka shku, ka  
2 ecë.

3 PY. Ju na thatë në fillim të faqes 64, që qëllimi i tij ishte  
4 të shkonte në front. A e dini ju se a shkoi në front, diçka që  
5 ju tha ai juve apo e patë ju që u nis për në front?

6 PË. Unë e di që mbasi që prej asaj dite deri herën e dytë kur  
7 e kam taku, e di që ai ka qenë njeri i fjalës edhe nuk ka qenë  
8 hera e parë se ai ka qenë një ndër ushtarët e parë që iu ka  
9 bashkangjitur UÇK-së qysh në vitet 1988, deri në fund të 1988  
10 ka qenë në zonën e Dukagjinit. Dhe ka qenë një ushtar i zoti,  
11 ushtar i aftë. Edhe e kam ditë që do të shkon dhe me siguri ka  
12 shku, jam i bindun 1 milion për qind që ka shku atje ku ka  
13 thanë.

14 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar,  
15 përpiguni që të përqendrohemi tek pyetja sepse pyetja ishte, a  
16 shkoi në front, kjo ishte pyetja. Në qoftë se ne duam që të  
17 jepni më shumë hollësi lidhur me këtë, ose të sqaroni më tej,  
18 ju japim këtë mundësi.

19 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

20 PY. Tani, z. Dëshmitar, folëm për këtë rastin e parë. A mund  
21 të na jepni një datë të përafërt të këtij takimi. Pra ndoshta  
22 muajin dhe vitin kur është zhvillu ky takim i parë, që të jemi  
23 të qartë.

24 PË. Unë të veçantë dikund q'aty mes 10-15 prill. Diçka  
25 q'ashtu. Se saktësisht nuk më kujtohet data, me të vërtetë. Se

1 ka kalu një kohë shumë e gjatë nga ajo periudhë.

2 PY. Faleminderit. Është shumë që ju kujtohet e gjitha kjo.

3 Tani kalojmë tek rasti i dytë, herën e dytë që u takuat  
4 me Pjetër Shalën. Kur dhe ku u takuat me të këtë herën e dytë?  
5 PË. Rasti i dytë ka qenë dikund para mbarimit të luftës. Në  
6 qershor. Edhe ky ka qenë një takim paksa më mirë, dhe më i  
7 relaksumë, për arsye se ishim të vetëdijshëm të dy që lufta  
8 është ka mbaron. Dhe rastësisht jemi taku në -- nuk jemi taku  
9 ma në uzinë, por jemi taku në qytetin e Kukësit.

10 PY. Faleminderit. Në këtë takim të dytë sa kohë u patë, sa -  
11 - në qoftë se ju kujtohet, sa kohë shkëmbyet, që ndejtët  
12 bashkë?

13 PË. Po kjo ka zgjatë pak më gjatë, për arsye se ishim pak më  
14 të relaksumë, dhe ishim në një kafene të qytetit të Kukësit.  
15 Edhe kemi pi nga një pije, dy. Kemi zhvillu një bisedë, ashtu  
16 them miqësore edhe si kushërinj. Edhe unë e kam pyetë,  
17 "Pjetër, çka tash, qysh i ki planet, çfarë planesh ki?" Se çdo  
18 një prej nesh i ka pasë planet e veta çka mbas lufte, mbasi të  
19 kryhet lufta, si do të vepron, çka do të bëjnë. Edhe më kujtohet  
20 fort mirë se më ka thanë që "Unë në qeto e kreu misionin tim.  
21 E kam kry edhe amanetin e babës". Për arsye se dëshira e tijna  
22 që baba i ka vdekë shumë para lufte, baba i tijna ka qenë një  
23 njeri kombëtar i madh, dhe ka pasë dëshirë që tana herë ta  
24 shoh Kosovën të çlirime.

25 Dhe më ka thanë që, "Unë e kam familjen të vendosur në



1 Belgjikë, dhe do t'i kthehena jetës time private, familjes  
2 time. Edhe do shkoj për Belgjikë.”

3 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A ju kujtohet se si ishte i  
4 veshur Pjetër Shala në këtë rast?

5 PË. Në atë rast ka qenë me tesha civil.

6 PY. A ju kujtohet si ishte veshur herën e parë kur jeni  
7 takuar?

8 PË. Herën e parë ka qenë me uniformë.

9 PY. A dini gjë ku vazhdoi ma tej, ku shkoi Pjetër Shala pas  
10 herës së dytë që u takuat, a keni njohuri a ndonjë dijeni për  
11 këtë se ku shkoi?

12 PË. Kam dëgju që ka shku për Belgjikë, për Bruksel. Atje ku e  
13 ka pasë edhe familjen, bashkëshorten dhe fëmijët.

14 PY. Faleminderit. A e keni pa më Pjetër Shalën mbas këtij  
15 rasti?

16 PË. Tash saktësisht, ndoshta data s'më kujtohet, por mbas  
17 disa viteve kur ka ardhë për vizitë në Kosovë, a ka qenë viti  
18 2005, 2006, 2004, me të vërtetë edhe këtë jemi taku në  
19 Prishtinë.

20 PY. Kjo pra i bie mbas luftës?

21 PË. Po, mbas lufte, mbas lufte, shumë mbas lufte.

22 PY. Faleminderit. Tani, gjatë luftës a keni patur ndonjë  
23 dijeni për ndonjë pozitë apo rol që ka pasë Pjetër Shala gjatë  
24 kohës kur e keni taku ju apo gjatë luftës?

25 PË. Nuk e kam pasë dijeni, veç e di që ka qenë ushtar. Ashtu

1 edhe kur e kam taku për herë të parë e kam pa si ushtar,  
2 ushtar të thjeshtë.

3 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Avokat,  
4 thjesht po ju kujtoj që na ka ngelur pak kohë përpara pushimit  
5 të drekës.

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Po, znj. Gjykatëse. Mund të  
7 përfundoj këtë pjesë brenda pak minutash. Sa i përket rolit  
8 dhe postit apo pozitës.

9 PY. Z. Dëshmitar, na thatë që ju kujtohet që jeni  
10 intervistuar nga kolegët tanë të ZPS-së. A ju kujtohet, a ju  
11 është treguar ndonjë dokument apo është dhënë ndonjë  
12 informacion lidhur me rolin e mundshëm të Pjetër Shalës?  
13 Pikësëpari, pyetja e parë është: Ju kujtohet ndonjë gjë e  
14 tillë që t'ju jetë treguar ndonjë dokument?

15 PË. Po, sa më kujtohet, ma kanë tregu një dokument edhe pak  
16 kam qenë si i habitur për arsye se e di që ndoshta, jo që  
17 ndoshta, por ajo, që ai njësit në të cilin ai është emëru si  
18 komandant i një brigade, që në atë kohë, në q'atë kohë as që  
19 ka ekzistue. Edhe e dyta, jam çuditë që Pjetri, bash Pjetri,  
20 të caktohet për komandant të asaj brigade. Duke e njoftë  
21 Pjetrin si unë e kam njoftë si fëmijë, por sa e di unë Pjetri  
22 e ka pasë një shkollim fillor të krymë. Pa dashtë që t'ia uli  
23 atë inteligjencën ose kualitetin e tijna, por për me udhëheqë  
24 një brigadë unë si ushtarak mendoj që duhet me qenë një njeri  
25 pak me një nivel ma të lartë, ma i shkollum, se brigada është

1 brigadë. Njerëz kryejnë jo vetëm akademi, por edhe shkollim  
2 edhe më të larta për me udhëheqë një brigadë.

3 E m'u ka dukë pak si e çuditshme tash sa i saktë është ai  
4 dokument, por atë dokument e kam pa që faktikisht edhe i  
5 nënshkrumë me ato, por unë personalisht mendimi im  
6 personalisht, mendoj që nuk është i saktë.

7 PY. Mos u shqetësoni për ofendime të mundshme, z. Dëshmitar,  
8 jeni këtu për të dhënë të vërtetën dhe këtë presim nga ju.

9 Z. AOUBINI: [Përkthim] Z. Gjykatëse, në qoftë se na i  
10 lejoni, do të donim t'i tregojmë këtë dokument dëshmitarit,  
11 dokumentin mbi të cilin dha vërejtje dhe komente. Dhe t'i  
12 kërkojmë hollësitë e tjera lidhur me këtë.

13 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo që dua të  
14 shmang, z. Avokat, është sepse nuk mendoj që do të jemi në  
15 gjendje të përfundojmë përpara orës 13.00. Do të preferoja që  
16 të respektojmë oraret që kemi caktuar edhe duke patur parasysh  
17 punën e përkthyesve. Pra juve do t'ju jepet koha e mjaftueshme  
18 më vonë pastaj, pas pushimit të drekës, që të vazhdoni dhe të  
19 plotësoni, përfundoni, marrjen në pyetje të dëshmitarit.

20 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.  
22 Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë pushim, pushim dreke, një orë e  
23 gjysmë. Dhe takohemi përsëri në 14.30. Znj. Sekretare do t'ju  
24 shoqërojë jashtë sallës së gjyqit. Faleminderit.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

1 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit,  
2 znj. Sekretare.

3 Takohemi, shihemi sërish në orën 14.30. Përpara se të  
4 ndërpresim seancën, a ka diçka që palët dëshirojmë të  
5 bashkëndajnë?

6 Z. AOUINI: [Përkthim] Me gjithë përpjekjet e mia, dhe në  
7 qoftë se s'ka ndryshime, do të na duhet pak a shumë edhe një  
8 gjysmë ore. Varësisht se si shkon me dëshmitarin.

9 KRYETARJA E TRUPIT VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.  
10 Në rregull atëherë, pushim dreke. Ndërpresim seancën.

11 --- Pauza e drekës fillon në orën 12.59

12 --- Seanca rifillon në orën 14.30

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
14 se u rikthyet pas pushimit të drekës.

15 Do vazhdojmë me pyetjet që i bëjnë dëshmitarit, z. Mark  
16 Shala. Shoh që në të djathtë është e njëjta përbërje. Dhe vlen  
17 edhe për Mbrojtësin e Viktimave dhe në këtë anë është e njëjta  
18 përbërje.

19 Z. GILISSEN: [Përkthim] Është thujse e njëjta.

20 Stazhierja është larguar. Ndërkohë kemi me ne dhe një  
21 punonjëse tjetër.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit shumë. Në rregull. Do të fusin dëshmitarin në  
24 sallë.

25 Znj. Asistente e sallë, ju lutem, shoqëroni dëshmitarit

1 që të hyjë në sallë.

2 Z. AOUBINI: [Përkthim] Nëse mundet të përmendim diçka.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Patjetër.

5 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit. Siç na autorizoi, e  
6 nderuar Gjykatëse, do t'i dërgojmë, do t'i tregojmë një  
7 dokument dëshmitarit. Përkthimi në anglisht i asaj faqe nuk e  
8 kemi në lisën e prezantimit; kemi diskutuar me kolegët dhe me  
9 Mbrojtësin e Viktimave, nuk shohim ndonjë problem, do t'ia  
10 japim dokumentin ERN të përkthimit në anglishte në mënyrë që  
11 t'i tregojmë të dyja.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Sigurisht, faleminderit. Kjo është organizuar. Për këtë besoj  
14 se pajtohem. Faleminderit.

15 [Dëshmitari vijon dëshminë]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë  
17 se u rikthyet z. Dëshmitar.

18 DËSHMITARI: Faleminderit. Mirë se ju gjeta.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të  
20 vijojmë me pyetjet të cilat do t'ju bëhet si dëshmitar. Do  
21 t'ia jap fjalën Avokatit të Mbrojtjes që të vijojë me pyetjet  
22 e tij. Keni fjalën z. Avokat.

23 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit.

24 PY. Mirëdita z. Dëshmitar.

25 PË. Mirëdita.

1 PY. Para se të fillonte pushimi po flisnim për një dokument  
2 të cilin po jua tregoja. Jo, një dokument të cilin, jua kanë  
3 treguar kolegët e ZPS-së gjatë intervistës së vitit 2019.

4 Propozoj që t'jua tregojmë tani dokumentin dhe t'ju bëjmë  
5 nga dy pyetje.

6 Z. AOUBINI: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, numri ERN  
7 është i njëjtë si më përpara 083525-083534 RED. Është faqja  
8 numër 8 e këtij dokumenti. Përkthimi në anglishte ndodhet në  
9 U00-, jo më falni 009-9398-U009-9398-ET.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

11 Faleminderit, znj. Sekretare.

12 Z. AOUBINI: [Përkthim] Faleminderit shumë.

13 PY. Z. Dëshmitar, a është ky dokumenti që jua kanë treguar  
14 gjatë intervistës me ju në vitin 2019?

15 PË. Po, ky është dokumenti i famshëm.

16 PY. Na folët për këtë dokument, por do ta marrim tani hap pas  
17 hapi. Çfarë do të thoshit ju, z. Dëshmitar, lidhur me këtë që  
18 thotë ky dokument për caktimin e komandantit Pjetër Shala  
19 "Ujku" për të drejtuar një brigadë sulmuese me numër 128 në  
20 Pashtrik?

21 PË. Po, unë e thashë edhe më parë, para këtij takimit se për  
22 mua është një dokument jo valid dhe dokumenta të tillë nuk  
23 shkruhen në këtë mënyrë.

24 Këtu shkruan "Autorizim". Autorizim edhe emërim në  
25 terminologjinë ushtarake është ka dallim. Se për me autorizu

1 dikën është që dikush veç është i vendosur, por autorizohet,  
2 për shembull, në këtë rast Pjetër Shala që ka udhëheq një  
3 brigadë të caktume të cilës ia kanë dhënë këto edhe emrin si  
4 brigada sulmuese 128 Pashtriku. E emërim është diçka tamam që  
5 në atë aspektin ushtarak i bjen që ai emërohet si komandant.  
6 Këtu është autorizim. E autorizim edhe emërim kanë dallim të  
7 madh.

8 PY. Faleminderit.

9 Z. AOUINI: [Përkthim] Ju lutem, që të shkojmë pak më  
10 poshtë te dokumenti origjinal në anglisht [sipas përkthimit]  
11 në pjesën e poshtme të faqes, sepse kam disa pyetje.

12 PY. Z. Dëshmitar, datën në fund majtas e shihni?

13 PË. Po.

14 PY. Më datë 20 mars 1999, që është data që duket dhe këtu në  
15 dokument, a ekzistonte kjo brigadë?

16 PË. Në atë kohë, faktikisht unë nuk kam qenë. Me 20 mars kam  
17 qenë. Edhe jo në Prishtinë. Këtu po thotë në Prishtinë.

18 Individit, personi që e ka nënshkru në këtë anë, as s'e ka qenë  
19 në atë kohë, por edhe para asaj kohe nuk ka qenë në Kosovë. Jo  
20 në Prishtinë. Tash këtu të jep me dyshu se bohet fjalë për një  
21 dokument për mu, për veten time është shumë i pakjartë dhe i  
22 pakuptimtë.

23 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. T'i marrim hap pas hapi, hap  
24 pas hapi. Do t'i kthehem edhe çështjes së Prishtinës, por  
25 data 20 mars 1999, kjo brigadë që ceket në dokument, na thatë

1 në faqen 67 në rreshtin 21, është 19 e tutje, thoni që ky  
2 dokument flet për një brigadë e cila nuk ekzistonte ende. Kjo  
3 është pyetje ime. Me aq sa keni ju dijeni, më datë 20 mars  
4 '99-s a ekzistonte një brigadë me këtë numër, numrin 128, që  
5 të ekzistonte, pra, atëherë?

6 PË. Jo, jo 100 për qind.

7 PY. Faleminderit. Tani, t'i kthehemi tani anës djathtë, por  
8 poshtë dokumentit ku shohim emrin e ministrit Azem Syla dhe  
9 nënshkrimi. Dhe ju sapo cekët Prishtinën. Na shpjegoni tani  
10 çfarë mund të thoni për se ku ndodhej Azem Syla atë datë në  
11 Prishtinë a diku tjetër.

12 PË. Azem Syla në atë kohë ka qenë në Shqipëri, në Tiranë.

13 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani --

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi  
15 Gjykses do të dijë se ku mbështetet kjo dijeni, se deri tani  
16 është thjesht një deklaram. Nuk mund ta mohoj apo kundërshtoj,  
17 por është thjesht një deklaram.

18 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Z. Dëshmitar, mbi ç'bazë thoni ju se Azem Syla nuk ishte  
20 në Prishtinë, por ishte në Shqipëri, e dini ju vetë  
21 personalisht këtë?

22 PË. Po mbas disa ditëve, kjo kështu këtu data është më 20  
23 mars. Unë kam ardhë aty nga fundi i marsit dhe unë Azem Sylën  
24 e kam taku në Tiranë.

25 PY. Po a e mësuat kur u takuat me Azem Sylën se ku ndodhej ai



1 më këtë datë, në Prishtinë apo diku tjetër? Pra, ju vetë a  
2 mësuat se ku ndodhej ai rreth datës 20 mars të '99-s?  
3 PË. Supozohej që s'ka mujt në të njëjtën kohë me konë edhe  
4 atje. Se me kalu prej Kosove, sidomos jo në Prishtinë, se në  
5 Prishtinë diçka të tillë s'ka mujt me ndodhë, me qenë ai në  
6 Prishtinë, edhe për një kohë të shkurtër me qenë me ardhë në  
7 Tiranë. Nuk besoj që ai ky dokument për atë arsye po them që  
8 nuk ka kuptim edhe nuk mundet me qenë i saktë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
10 jua lë juve. Unë thjesht desha që të kuptoja bazën mbi të  
11 cilën mbështetet ajo që tha dëshmitari.

12 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara Gjykatëse.  
13 PY. Z. Dëshmitar, po ta heqim mënjanë këtë dokument, a keni  
14 ju dijeni që Pjetër Shala në ndonjë moment të ketë pasur një  
15 rol komandues të një brigade të tillë. Pra, kjo që thuhet këtu  
16 në dokument, a përputhet me atë që dini ju?

17 PË. 100 për qind Pjetër Shala nuk ka qenë, edhe kjo brigadë  
18 në atë kohë as që ka ekzistuar. Unë personalisht nuk kam dëgju  
19 për këtë brigadë dhe që ka, e di që ma vonë diçka tjetër është  
20 formu nën udhëheqjen e një njeri tjetër, jo Pjetër Shalës ku  
21 në atë drejtim ka qenë edhe vetë Pjetër Shala, jo si  
22 komandant, por si ushtar i thjeshtë.

23 PY. Pyetja që kam është kjo: A keni ju dijeni personale për  
24 ndonjë rol strukturor apo ndonjë gradë që mund të ketë pasur  
25 Pjetër Shala gjatë kohës së luftës?

1 PË. Gjatë kohës së luftës në vitet '98 sipas që kom dëgju në  
2 anën e Dukagjinit e ka pas një ka qenë komandant i një togu.  
3 Kurse në vitin '99 sa ka qenë me qendrën stërvitore në Burrel,  
4 më duket se ka qenë një komandant i një gjithashtu më duket ma  
5 si i togut ose diçka ma e vogël të policisë ushtarake. Por në  
6 Kukës nuk e di për ndonjë rol tjetër që ka pas ose ndonjë  
7 pozitë tjetër çfarëdo lloj komandues ai, sidomos jo të  
8 komandant të këtë brigadës, sikur që është e shënume këtu në  
9 këtë autorizim. Jo vendim, por autorizim.

10 PY. Për të qenë të qartë, z. Dëshmitar. Na thatë më herët sot  
11 se Pjetër Shala ishte ushtar. I qëndroni kësaj deklaratë që  
12 ishte një ushtar i thjeshtë apo po thoni se kishte edhe ndonjë  
13 rol apo post tjetër?

14 PË. Në atë kohë kur unë e kam takue ka qenë ushtar i  
15 thjeshtë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
17 Avokat, më duket se e morëm përgjigjen që ai ka qenë ushtar i  
18 thjeshtë dhe tani morëm përgjigjen se në një moment të caktuar  
19 kohor ka qenë komandant i një togu. Nuk, domethënë, unë e  
20 kuptoj se çfarë doni të arrini me këtë, por e kemi përgjigjen.  
21 Na ka dhënë dy përgjigje për këtë temë.

22 Nëse doni t'i propozoni një kundërthënie është tjetër.  
23 Mundet ta shihni më tej këtë çështje, por duhet ta bëni  
24 pyetjen ndryshe. Se kështu siç ia bëtë pyetjen tani gati-gati  
25 po e shtyni që të mohojë atë që sapo tha, që ishte komandant

1 togu. Kështu e kuptova unë. Nuk dua t'ju kufizoj lidhur me  
2 pyetjen që do e bëni, por e kam këtë merak.

3 Z. AOUINI: [Përkthim] Po përpiqesha ta sqaroja. Mbase  
4 edhe mund të pyesim se çfarë ka dashur të thotë me "togun",  
5 thjesht për ta sqaruar për hir të Gjykatësve.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull, vetëm se duhet ta riformuloni. Mund ta pyesni, për  
8 shembull, është pse ka thënë përpara që ka qenë ushtar i  
9 thjeshtë, ndërkohë që tani thotë që ka qenë komandant i një  
10 togu në vitin '99.

11 Ose mund ta pyesni për kohën kur ka qenë komandant i  
12 togut. Mund të ndihmonte. Pra, do t'i qasesha ndryshe kësaj  
13 çështjeje.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit.

15 PY. Z. Avokat [sipas përkthimit] në faqen 67, rreshti 9, na  
16 thatë se kur e takuat Pjetër Shalën në uzinën e Kukësit, ju  
17 duk sikur ishte ushtar i thjeshtë. Tani sapo na dhatë një  
18 tjetër përshkrim, pra, si komandant i një togu. Mund të na  
19 thoni se kur ka qenë komandant togu në raport edhe me kohën  
20 kur jeni takuar me Pjetër Shalën, pra, përpara se e takuat,  
21 mbasi e takuat. Nuk po flasim për vitin '98. Thjesht që të  
22 jemi të qartë.

23 PË. Po, unë qëndroj pas asajna çka e kam thënë e jam nga e  
24 thonë, por nuk e di a po kuptohet. Se unë thashë se ndanë disa  
25 periudha e të veprimit të Pjetrit derisa kam ardhë unë e jemi

1 taku dhe ajo periudhë [e pakuptueshme] para se me ardhë unë,  
2 që ai ka ardhë përpara dhe fillimisht ka qenë në Burrel dhe  
3 pastaj ka ardhë në Kukës. Unë kur e kam taku, [e pakuptueshme]  
4 ka qenë si ushtar i thjeshtë. E tash them se ka qenë ushtar i  
5 thjeshtë.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
7 falni, z. Avokat. Kur ka qenë ai i ashtuquajtur komandant  
8 togu?

9 DËSHMITARI: Ndoshta, veç ai ka ardhë shumë më përpara në  
10 Shqipëri nga Belgjika edhe sa ka qenë, se ka qenë një kohë, ka  
11 shku prej, kur ka arrit në qendrën stërvitore në Burrel, edhe  
12 atje ka qenë më duket, se më duket komandant togu të policisë  
13 ushtarake. Ashtu, ashtu kam dëgju.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
15 ta kuptuar mirë, sa i takon kohës, kohës se kur. Pra, nuk ka  
16 qenë në mars të viti '99, përpara prillit të '99-s.

17 DËSHMITARI: Po e them, para se me ardhë unë ai ka qenë  
18 një kohë në Burrel, por në Kukës nuk ka qenë as komandant  
19 togu, as komandant brigade, ka qenë një ushtar i thjeshtë.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se  
21 dua unë që ta kuptoj kohën, datën qartë. Pra, a dini gjë kur  
22 ka qenë në Burrel komandant togu?

23 DËSHMITARI: Unë kam ardhë në fund të marsit. Sigurt që e  
24 kam cek edhe përpara edhe në fillim të qershorit jemi ne jemi  
25 taku edhe na jemi taku në atë mënyrë sikurse që e kam përshkru

1 edhe përpara. Edhe në atë kohë ka qenë ushtar i thjeshtë.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbase  
3 nuk jua bëra unë pyetjen qartë. Do ta bëj edhe një herë  
4 pyetjen. Më falni, nuk dua që t'ju ngatërroj.

5 Unë, nga dëshmia juaj në sallë, e kuptova kështu që kur  
6 je taku me z. Shala si në fund të marsit, fillim të prillit,  
7 edhe sapo thatë tani në qershor të '99-s se sipas fjalëve të  
8 tuaja po flas ishte ushtar i thjeshtë, me aq sa dini ju.

9 DËSHMITARI: Po.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.  
11 Këtë e kam kuptuar mirë. Tani pyetja që desha të bëjë është  
12 kjo: A dini gjë kur ka qenë z. Shala në Burrel komandant togu  
13 apo diçka si togë, për ç'periudhë kohore flasim dhe e dëgjova  
14 që thatë "ishte përpara, përpara se jam ardhë unë", pra, edhe  
15 ju keni shkuar aty dikur nga fundi i marsit, duke 26 mars,  
16 diçka e tillë. Por unë do të doja të dija nga ju tani, sipas  
17 asaj që dini ju, kur ka qenë ai komandant togu në periudhën  
18 përpara kësaj kohe?

19 DËSHMITARI: Po. Unë saktësisht nuk e di kur ka ardhë ai  
20 me cilën datë, por e di se kur unë e kam taku. Edhe e di që  
21 fillimisht kur ka ardhë ka qenë një herë në Burrel edhe prej  
22 Burrelit ka ardhë në Kukës. Atëherë kur kam ardhë unë, në  
23 fillim të prillit e kam taku edhe në atë kohë ai ka qenë  
24 ushtar i thjeshtë. Mirëpo, sipas që kam dëgjue nga disa, sa ka  
25 qenë në Burrel e ka lujt rolin e një komandanti togut dikun 10

1 deri 15 ushtarë i ka pas nën komandën e tina.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
3 pyetja ime qëndron, nëse mund të na thoni kohën, por edhe nëse  
4 nuk mund ta thoni, na e thoni.

5 DËSHMITARI: Nuk e di.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
7 rregull. A kam edhe një pyetje tjetër nga ana jonë. Deri kur  
8 keni qëndruar në Kukës? Domethënë tek uzina e Kukësit.

9 DËSHMITARI: Unë personalisht?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
11 ju, ju personalisht.

12 DËSHMITARI: Deri në hyrje të trupave tonë në Kosovë.  
13 Domethënë deri në mbarim të luftës kam qenë në Kukës apo në  
14 Krume apo diku andejna në veri të Shqipërisë, gjithë kohën.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Datën  
16 mund ta thoni?

17 DËSHMITARI: Domethënë prej kur kam ardhë në mbarim të  
18 marsit edhe deri dikun aty 10-11 qershor.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
20 Avokat i Mbrojtjes, keni sërish fjalën.

21 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.  
22 Faleminderit, z. Dëshmitar për shpjegimet.

23 PY. Kam një pyetje në bazë të kësaj. Në fakt na thatë në  
24 faqet 76, rreshti 21 deri 25 dhe faqen 78, rreshtin 10 deri 13  
25 se kishit dëgjuar se Pjetër Shala ishte komandant toge. Prej

1 kujt e dëgjuat, nëse ju kujtohet?

2 PË. Po prej disa pjesëtarëve që kanë qenë atje në atë qendrën  
3 e trajnimit edhe cilët kur ka fillu operacioni "Shigjeta" ata  
4 të gjithë kanë ardhë këtu në se Burreli është dikun më afër  
5 atje ndërmjet Tirane e Kukësit edhe atëherë kur janë ardhë nga  
6 Burreli në veri të Shqipërisë gati ca persona që kanë qenë në  
7 atë kohë në trajnime këtu në bisedë e sipër kam dëgju që ka  
8 qenë edhe Pjetri atje dhe ka qenë si udhëheqës i një grupi të  
9 ushtrisë, të policisë ushtarake.

10 PY. Faleminderit. Sa ushtarë mendoni se i ka një togë?

11 PË. Togu mundet me i pas 15, 20 deri në 30 ushtarë.

12 PY. Dëgjuat se cila togë ishte? A kishte ndonjë emërtim,  
13 ndonjë emër?

14 PË. Sidomos togjet sigurt sikurse është, për shembull,  
15 policia ushtarake ose ndonjë specialitet tjetër, thirret tamam  
16 me emër të atij, për shembull, në qoftë se është policia  
17 ushtarake, thirret togu i ushtrisë, i policisë ushtarake. Nuk  
18 ka tjetër emërtim, mundet me qenë, mundet në qoftë se ka më  
19 shumë njësite të njëjtë të njëjta atëherë edhe emërtohen ose i  
20 me numra ose me emra me [e pakuptueshme].

21 PY. Faleminderit. Na thatë se dëgjuat nga miqtë të njohur me  
22 të cilët keni biseduar, por ndonjë emër keni? Nga kush e  
23 dëgjuat?

24 PË. S'po më kujtohet.

25 PY. Z. Dëshmitar, na thatë se kur u takuat për herë të parë

1 me Pjetër Shalën më duket se përmendët 10 deri 15 prill në  
2 uzinën e Kukësit. Ai mori një armë, një snajper nga  
3 departamenti juaj dhe u largua për në front. A keni dijeni se  
4 në ç'drejtim të frontit ndodhej ai? Dini gjë?

5 PË. Më duket që ka shku në drejtimin e katërt që ka qenë në  
6 drejtim të Kukës-Gorozhup-Morinë, Qafë Morinë.

7 PY. Faleminderit shumë, Z. Dëshmitar. Pyetjet e tjera, në  
8 pyetjet e tjera, z. Dëshmitar, do t'ju pyes për disa individë.  
9 Do t'ju tregoj disa fotografi.

10 Z. AOUINI: [Përkthim] Me lejen e të nderuarve Gjykatës,  
11 dëshiroj që të kaloj në seancë private për të bërë një pjesë  
12 të këtij procesi.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
14 Sekretare, ju lutem, na kaloni në seancë private.

15 [Seancë private]

16 [Seancë private teksti i fshirë]

17

18

19

20

21

22

23

24

25



1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: W04754 (Seancë private)  
Pyetje nga z. Aouini

Faqe 90

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

[Seancë e hapur]

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani jemi në seancë

18 publike.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit, znj. Sekretare.

21 Z. Avokat, keni fjalën.

22 Z. AOIINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryegjykatëse.

23 Nëse mund të kalojmë tek dokumenti ERN 083525, i njëjti

24 dokument që kemi përdorur sot, por kësaj radhe në faqen 9 ku

25 kemi një fotografi.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

2 Sekretare, mund të nxirrni dokumentin që u kërkua.

3 Z. AOUINI: [Përkthim]

4 PY. Z. Dëshmitar, a ju kujtohet që ju është treguar kjo  
5 fotografi në intervistën tuaj në vitin 2019?

6 PË. Po.

7 PY. A njihni dikë nga këta persona këtu, përfshirë edhe veten  
8 tuaj, në këtë fotografi?

9 PË. Po ma së miri po njoh veten. Po i kam shënu këtu me  
10 numra. Numri, me ia fillu prej t'fundit apo të parit, numri 1  
11 Bislim Zyrapi; 2 Spiro Butka, që ky 3 Sylejmani e ka pas  
12 mbiemrin, një djalë nga Llapi, këtë numër 4 me të vërtetë s'po  
13 më kujtohet tash. A ka qenë përcjellës apo asistent i Bislim  
14 Zyrapit, nuk po më kujtohet. Ky numër 5 edhe ky është Shala,  
15 Alush Shala edhe numër 6 është Mark Shala.

16 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Do t'ju bëjmë disa pyetje  
17 lidhur me personat që janë në këtë fotografi. Së pari, a ju  
18 kujtohet kur është marrë, bërë kjo fotografi dhe ku, kur dhe  
19 ku?

20 PË. Kjo është marrë në muajin maj dikun. Edhe këtu në këtë  
21 zyrë e ka shfrytëzue Bislimi, Bislim Zyrapi, në zyrën e tina.  
22 Ka qenë një kështu mas takimit e kemi pi nga një kafe në një  
23 takim kemi pas përpara dhe pasanej, ku shihen edhe kafet,  
24 është kone e lejume edhe duhani atëherë me e pi edhe duhan nga  
25 një cigare duhan e kemi dhez. Më kujtohet dikun maj, por data



1 saktësisht nuk më kujtohet.

2 PY. Kuptohet vetvetiu, por besoj që është maj '99 apo jo?

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
4 konkretisht, vendi ku është bë kjo fotografi, ku?

5 Z. AOUBINI: [Përkthim]

6 PY. Na thatë që është bërë kjo fotografi pas një takimi, a  
7 mund të na thoni në cilën zyrë ose ndryshe. Në përgjithësi e  
8 di se ku është bërë kjo fotografi?

9 PË. Në katin e dytë ka qenë një aty afër zyra e afër qendrës  
10 operative, në zyrën e Bislimit, Bislim Zyrapit. Në atë kohë e  
11 ka shfrytëzu ai si sa ka qëndru në Kukës e ka shfrytëzu për  
12 takime këtë zyrë, zyrën e tina.

13 PY. Dhe nga informacioni që morëm deri tani, që na dhatë ju,  
14 kati i dytë ka qenë i pranishëm vetëm te kjo ndërtesa që ju e  
15 keni shënuar me numër 2, se ka qenë ndërtesa e komandës, është  
16 vendi ku ka, ku gjendej kjo zyrë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pra,  
18 në uzinën metalike që të jetë e saktë.

19 Po ju shoh që po lëvizni kokën në shenjë pohuese. Do të  
20 thotë, po.

21 Z. AOUBINI: [Përkthim]

22 PY. Tani, ju përmendët në numrin 2, Spiro Butka, dhe më herët  
23 biseduam për një oficer shqiptar që ishte në ndërtesën numër  
24 2, në pjesën operative, faqen 27, rreshti 2 dhe 4. A është ky  
25 i njëjti person për të cilin po flasim, Spiro Butka?

1 PË. Po, i njëjti është.

2 PY. Tani, në qoftë se shikojmë numrin 5, na thatë se është

3 Alush Shala, para pak çastesh, çfarë mund të na thoni për këtë  
4 person, Alush Shala?

5 PË. Ne kur kemi ardhë në Kukës ky veç ka qenë aty edhe sa di  
6 unë ai qysh ka tregu, ka qenë një kohë bukur të gjatë në  
7 Shqipëri edhe para se me fillu lufta ka qenë i burgosun  
8 politik edhe po më duket se e ka lëshu Kosovën qysh përpara  
9 edhe është bo, atje ka kalu në Shqipëri dhe ka bo organizime  
10 të ndryshme në lidhje me përgatitjet për luftën në Kosovë.

11 PY. Në kohën kur është bo kjo fotografi a e dini cili, çfarë  
12 roli ka pas ky, çfarë pozite, në cilin grup ka bë pjesë apo  
13 ndonjë hollësi apo detaj për rolin e tij, apo pozicionin e  
14 tij, grupin?

15 PË. E di që veç nuk ka qenë pjesëtar i logjistikës. Ka qenë  
16 nën, me sa di unë ka qenë nën komandën e Xheladin Gashit. Të  
17 atij grupit të parë që kanë qenë qysh prej vitit '97-'98 dhe  
18 që kanë qenë qysh herët ata në Shqipëri. Ai ka qenë në atë  
19 ekip. Nuk ka qenë në logjistikë. Çfarë kanë qenë në logjistikë  
20 për secilin e di çfarë roli dhe çfarë pozite ka pas. Për këta  
21 të tjerët nuk e di. Veç e di që ka ardhë aty në takim. Po  
22 çfarë roli ka pas nuk e di as sot.

23 PY. Që të jemi të qartë. Ju thatë që ka qenë nën Xheladin  
24 Gashin. A do të thotë kjo që seksioni ku ka punu ky apo  
25 departamenti ku ka punu ky ka qenë pjesë për mobilizim?

1 PË. Po në përgjithësi më duket me ç'ato punë. Po saktësisht  
2 nuk e di.

3 PY. Ju kur e keni parë çfarë keni vërejt që vepronte që bënte  
4 që të na ndihmoni që të kuptojmë ne rolin e tij, pra, thatë që  
5 ka qenë pjesë e një grupi që nga viti 1997. A mund të na thoni  
6 ndoshta pak më shumë në hollësi se çfarë e keni pa ju atë duke  
7 bo, me çfarë merrej?

8 PË. Pasi ky ka qenë për një kohë të gjatë aty në Shqipëri, sa  
9 kam mujt unë me vërejt ky ka qenë edhe njëfarë, se ka njoft  
10 shumë njerëz si aty të vendit, por edhe të ushtrisë së  
11 Shqipërisë. Ka qenë njëfarë lloj ndërlihdhësi mes UÇK-së dhe të  
12 njerëzve vendorë dhe ushtrisë së Shqipërisë.

13 PY. Faleminderit. Sa shpesh e ka pa atë në uzinë? Pra, a  
14 ishte i pranishëm aty pjesën më të madhe të kohës, a e ke pa  
15 rrallëherë, mund të na përshkruani pak sa ka qenë i pranishëm  
16 ai në këtë uzinë?

17 PË. Po nuk ka qenë shumë i pranishëm; ka qenë non-stop në  
18 terren; ka qenë jashtë. E di që edhe ka flejt jashtu dikun,  
19 nuk gjatë ditës ka qenë më shumë kështu. Nga një herë kur kam  
20 ardhë jemi taku, por jo shumë rrallë, shumë shpesh, më falni.

21 PY. Tani në këtë fotografi, ndoshta e fundit, a e dini për  
22 çfarë është biseduar gjatë këtij takimi apo grumbullim,  
23 mbledhje që e shohim këtu, personat e pranishëm në këtë  
24 fotografi?

25 PË. Po çdo takim ka qenë rreth aktiviteteve, rreth

1 organizimit, rreth punëve që është dashtë me i kry. Unë e kam  
2 pas atë sektorin tim të logjistikës. Kam marrë detyrë të  
3 ndryshme rreth furnizimit, rreth furnizimit me automjete, me  
4 armatim, municion, me derivate, me këto punë. Domethënë me  
5 transport. Gjithë ato çka i kanë janë konë punë të  
6 logjistikës.

7 PY. A ju kujtohet pjesëmarrja e Alush Shalës në këtë bisedë?  
8 Çfarë kontributi, çfarë pjesëmarrje pat?

9 PË. As nuk më kujtohet se çka ai ka bisedu, por ka qenë ky  
10 takim gati me të, kjo fotografi ka qenë e rastësishme, që ky  
11 nuk ka marrë pjesë në të gjitha takimet që i kemi pas ne me  
12 komanda që ka qenë në krye me Bislime Zyrapin.

13 PY. Faleminderit.

14 Z. AOUINI: [Përkthim] Znj. Gjykatëse, kemi përfunduar  
15 pyetjet lidhur me këtë fotografi.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
17 Sekretare, mund ta hiqni fotografinë nga ekrani.

18 Z. AOUINI: [Përkthim]

19 PY. Z. Dëshmitar, cekët më herët dikë të quajtur si Zijadin  
20 Hoxha. Kush ishte ky?

21 PË. A bon me e përsërit edhe një herë?

22 PY. Më herët sot folët, kur po diskutonim për këto shënime  
23 në fotografi, një ushtar me emrin Zijadin Hoxha. Dua t'ju pyes  
24 me hollësi se kush është ky? E përmendët në paragrafin 49,  
25 besoj se është Selajdin Hoxha, në --

1 PË. Zijadin Hoxha.

2 PY. Pikërisht, Zijadin, Zijadin Hoxha.

3 PY. Ai ka qenë si komandant i njësitit e cila është marrë me  
4 mirëmbajtjen e armatimit. Ka shku në terren; ka bë mbledhjen e  
5 armatimit që ka qenë, ka pas defekte, kanë qenë të dëmtuara, i  
6 ka marrë, i ka pru deri në atë servis atje ku e kem tregu ku  
7 ka qenë për mirëmbajtje të armatimit. Aty e ka pas njëfarë  
8 servisi që i ka rregullu. E ka bo ndërrimin, atij që iu ka  
9 prish, ia ka dhënë tjetrën, e ka marrë atë të me defekt. Edhe  
10 më këto gjëra është marrë. Ka qenë kryesisht njohës i mirë i  
11 armatimit.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dy  
13 gjëra, z. Avokat. Pyetja ime është kjo: A do të bëni pyetje të  
14 tjera për këtë person konkret?

15 Z. AOUINI: [Përkthim] Unë propozoja të konstatojm se në  
16 cilin njësit bënte pjesë dhe pastaj do merremi me emra të  
17 tjerë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, e  
19 kam fjalën për këtë person. Pra, vetëm sektorin apo seksionin.

20 Z. AOUINI: [Përkthim] Po.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Atëherë, për t'ju informuar se jemi afër tri orëshit që keni  
23 kërkuar. Sigurisht nuk dua t'ju ushtroj presion që ta  
24 përshpejtoni, por thjesht ta dini, ta mbani parasysh.

25 Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Shpresojmë të

1 përfundojmë brenda 10 minutave, por nuk premtojmë.

2 PY. Një pyetje të fundit, z. Dëshmitar, për Zijadin Hoxhën.

3 Thatë që riparonte armë, do të thotë që ishte pjesë e sektorit  
4 tuaj, e logjistikës apo bënte pjesë në një sektor tjetër?

5 PË. Jo, ka qenë pjesë e sektorit të logjistikës.

6 PY. Faleminderit. Keni parë ndonjë person të quajtur Bardhyl  
7 Mahmuti në uzinë gjatë kohës që keni qenë ju aty?

8 PË. Jo.

9 PY. A e njihni një person të quajtur Bardhyl Mahmuti?

10 PË. Po, si jo.

11 PY. Pra, atë e njihni, por e pohoni se nuk e keni parë aty  
12 vetë, kështu?

13 PË. Me e njoftë e njoh, për të kam dëgju edhe para se me u  
14 kyç unë në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Ai ka qenë si  
15 zëvendës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në mërgim, jashtë  
16 Kosove. A për me e njoh kështu personalisht e kam njoftu mas  
17 lufte në Prishtinë.

18 PY. E qartë, faleminderit. Keni parë ndonjëherë Daut  
19 Haradinajn në uzinën e metalit në Kukës?

20 PË. Jo, asnjëherë.

21 PY. E njihni Daut Haradinaj?

22 PË. Vetëm pas lufte.

23 PY. E njëjta pyetje vlen edhe për Ramush Haradinaj. Ramush  
24 Haradinajn a e keni parë ndonjëherë në uzinën e metali në  
25 Kukës?

1 PË. Edhe atë kurrë s'e kam parë.

2 PY. Por e njihmi, është person që e njihni?

3 PË. Për me e njoft e njoh, edhe dëgju kam për të. Ai ka qenë

4 komandant i zonës operative të Dukagjinit edhe më ka ra me e

5 njoftu mbas lufte. Bile e kam pas edhe një kohë, si ka qenë

6 zëvendëskomandant i Trupave të Mbrojtjes së Kosovës në

7 Prishtinë. E kam pas edhe unë si komandant, se unë kam qenë në

8 Shtab të Përgjithshëm, edhe prej atyit e njoh. Përndryshe,

9 përpara s'e kam njoft.

10 PY. Faleminderit. E njihni dikën me emrin Osman Kryeziu?

11 PË. Jo.

12 PY. Po dikë me emrin Ruzhdi Saramati?

13 PË. Më fal, ndoshta Kadri Kryeziu, po. A Osman Kryeziu, jo.

14 Këtë nuk di për kon e keni a është Osman Kryeziu apo Kadri

15 Kryeziu?

16 PY. Jo, e kam fjalën për Osman Kryeziun. Por ky Kadriu, Kadri

17 Kryeziu ka ndonjë farë lidhje me uzinën e metalit të Kukësit,

18 se nëse nuk ka atëherë nuk na intereson.

19 PË. Jo, nuk ka kurrfarë lidhje.

20 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Dikën me emrin Ruzhdi

21 Saramati, e njihni?

22 PË. Po, Ruzhdi Saramatin e njoh.

23 PY. Kush është? Çfarë, domethënë, çfarë dini për të në lidhje

24 me luftën?

25 PË. Thashë, na kur kemi ardhë në Kukës, aty e kemi taku

1 Ruzhdi Saramatin dhe kur me fillimin e ose para fillimit të  
2 operacionit "Shigjeta", Ruzhdi Saramati është caktuar si  
3 komandant i një drejtimi në operacionin "Shigjeta".

4 PY. Pra, ishte i caktuar për një prej drejtimeve. Por çfarë  
5 posti kishte, në ç'post ishte emëruar?

6 PË. Komandant.

7 PY. A dini gjë çfarë brigade, njësi apo grupi komandant  
8 ishte ai?

9 PË. Po në operacionin "Shigjeta" kanë ekzistuar katër  
10 drejtime. Në një drejtim ka qenë Ruzhdi Saramati i caktuar  
11 edhe ato njësite kanë qenë dikun të nivelit të nivelit të  
12 batalionit, diçka pak ma tepër, por të nivelit të batalionit,  
13 jo më shumë.

14 PY. Mund ta thoni sa i madh është një batalion, për ne që nuk  
15 e dimë. Pra, sa ushtarë i ka një batalion?

16 PË. Një batalion mundet, varet çfarë tipit është. E  
17 këmbësoria mundet me i pas 600, por në qoftë se ka edhe  
18 njësite të tjera diçka përcjellëse, artileri ose diçka tjetër  
19 mundet me qenë edhe ma i gjonë, ma i madh. Mirëpo, këmbësoria  
20 i ka diku deri 600 veta.

21 PY. Po të flasim për grupin, komandant i cilit ishte Ruzhdi  
22 Saramati. Sa ushtarë i kishte, nëse e ke, nëse e dini?

23 PË. Ai ka pas një drejtim, këtë drejtim Kukës-Gorozhup-Qafë  
24 Morinë. Dhe sa di unë, në atë kohë, ai ka pas dikun 150-200  
25 ushtarë. Sa e di unë.



1 PY. Dini gjë për brigadën që përmendëm më herët, Brigada 128?

2 PË. Jo.

3 PY. Tani, po t'i kthehemi drejtim të ushtarëve bashkë me  
4 Ruzhdi Saramatin, a ju kujtohet gjatë kohës që ju vetë keni  
5 shërbyer, pra, gjatë operacionit "Shigjeta", kur ka shkuar në  
6 front ky grup?

7 PË. Ky grup ka shku dikun mas 20 majit, dikun q'aty mas 20  
8 majit ka shku në drejtim të Gorozhupit.

9 PY. Faleminderit. Mund të na thoni në cilin kohë është  
10 caktuar si komandant i këtij grupi Ruzhdi Saramati dhe e ka  
11 drejtuar këtë grup drejt frontit?

12 PË. Në atë kohë komandanti i operacionit "Shigjeta" ka qenë  
13 Fatmir Lima, Limaj, dhe si komandant ka caktue si komandant të  
14 atij drejtimit që e thashë edhe më parë.

15 PY. Z. Dëshmitar, e kam për kohën, datën, keni ndonjë datë.  
16 Sepse thatë që rreth majit, pas 20 majit ky grup shkoi në  
17 front. E dini datën se kur ka ndodhur emërimi i tij, përpara,  
18 sa kohë përpara, pas kësaj date, në cilin moment?

19 PË. Para se të fillojë operacioni, disa ditë përpara është  
20 caktu si komandant dhe ai e ka pas për detyrë që ta organizojë  
21 njësitin; ka marrë ushtarë nga qendrat stërvitore që kanë qenë  
22 veç në stërvitje e sipër; e ka formue atë njësitin e vet edhe  
23 ka kur është dhënë urdhri që të fillojë operacioni edhe ai në  
24 të njëjtën kohë ia ka fillua me luftime në drejtim të  
25 Gorozhupt.

1 PY. Faleminderit. Meqë se po flasim për Gorozhupin, ju  
2 kujtohet në cilin moment gjatë qëndrimit tuaj në uzinën e  
3 Kukësit, a ka pasur anëtarë të këtij grupi që të jenë lënduar  
4 në front?

5 PË. Po jo vetëm të lënduar, por ka pas edhe të vrarë; ka pas  
6 dikun 5-6 ushtarë kanë qenë të vrarë dhe dikun përmbi 10 kanë  
7 qenë të lënduar. A në mesin e tyre ka qenë edhe një i afërt i  
8 Ruzhdi Saramatit me emrin Sali Saramati. Ai ka qenë i vra.

9 PY. Mund të na thoni se kur kanë ndodhur këto ngjarje, pra,  
10 lëndimet edhe vdekjet e ushtarëve të atij grupi?

11 PË. Po pas fillimit të operacionit, më duket 2-3 ditë mbasi  
12 ka fillu operacioni në luftimet e para ka ndodh ajo. Shumë  
13 shpejt nga artileria serbe janë godit një grup i ushtarëve të  
14 tina dhe ka ndodh të njesin e të vdekun 6 vetë edhe të  
15 plagosur dikun përmbi 10 pjesëtarë të UÇK-së.

16 PY. Cekët se edhe një i afërm i Ruzhdiut ra si rezultat i një  
17 sulmi nga serbët. Dini gjë nëse një apo shumë familjarë apo të  
18 afërm të tjerë të Ruzhdiut mund të jenë lënduar apo të kenë  
19 vdekur gjatë të njëjtit sulm?

20 PË. Sa e di unë ka qenë q' ai i afërti i tina. Më duket se ka  
21 qenë edhe një edhe disa njerëz të tjerë të afërt të tina që i  
22 ka pas ndoshta edhe familjarë që janë vrarë në të njëjtin  
23 grup.

24 PY. Nga informacioni, nga burime të hapura që kemi për atë  
25 periudhë, është një ushtar me emrin Gani Saramati, i cili ka

1 vdekur gjatë asaj periudhe. E identifikoni edhe këtë si mbase  
2 një prej ushtarëve të rënë në betejë, atëherë? Ju kujtohet?

3 PË. Po me siguri, po. Po mu s'mu kujtu si emër.

4 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. A ju kujtohet nëse është  
5 zhvilluar ndonjë funeral apo ndonjë trajtim që mund të ketë  
6 ndodhur si rezultat i kësaj ngjarjeje që është zhvilluar në  
7 front. Pra, diçka një ngjarje që të ketë ndodhur edhe në  
8 fabrikën në uzinën e Kukësit, diçka që ka ndodhur pas këtij  
9 sulmi nga serbët?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z.  
11 Dëshmitar, mos u përgjigjuni. Shoh që Prokurorja është ngritur  
12 në këmbë.

13 Znj. Prokurore, mos duhet ta nxjerrim jashtë sallës  
14 dëshmitarit?

15 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Jo. Të nderuar Gjykatës, thjesht  
16 desha të them, hezitua që të ndërpresim, por po na duket se  
17 pyetjet po bëhen gjithnjë e më shumë orientuese, sidomos kjo e  
18 fundit. Mendojmë se dëshmitarit mund t'i bëjmë pyetje më të  
19 hapura. Pra, për shembull, të thuhej se çfarë ndodhi më mbrapa  
20 dhe jo të thuhet brenda pyetjes edhe vendi, edhe ngjarja. Ky  
21 është kundërshtimi ynë.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
23 Faleminderit, znj. Prokurore. Jam e sigurt që këtë mund ta  
24 mbaja parasysht z. Avokat i Mbrojtjes.

25 Z. AOIINI: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës. Por po

1 përpiqesha të mbyllja një pikë të padebatueshme. Megjithatë,  
2 do ta bëj pyetjen.

3 PY. Z. Dëshmitar, ju kujtohet se çfarë ju ka ndodhur  
4 ushtarëve të lënduar e të vrarë të cilët ranë në front? Keni  
5 dijeni se çfarë ndodhi me ta?

6 PË. Me të gjithë ushtarët, jo vetëm ushtarët e Ruzhdi  
7 Saramatit, por edhe ushtarë të tjerë që kanë ra në drejtime të  
8 tjera, ata që kanë vdekur, për gjithë është bo një funeral  
9 edhe janë varros me nderime ushtarake në varrezat e Kukësit,  
10 të gjithë. Kurse ata që kanë qenë të lënduar janë tërhek nga  
11 vendi që ku kanë qenë, ku iu ka ndodh lëndimi dhe janë dërgu  
12 në ata që kanë qenë të lëndum ma lehtë ose të them që kanë pas  
13 plagë më të lehtë, në këto spitalet fushore, që kanë qenë në  
14 Krumë edhe në Helshan. Kurse raste diçka më të rënda janë  
15 dërgu në spitalin civil në Kukës. Por ka pas me lëndime shumë  
16 të rënda që kanë mujt me mbijetu. Ata janë dorëzue për Tiranë.  
17 E ka pas rast që edhe pse kanë shku në Tiranë, por ose gjatë  
18 rrugës ose në spital atje ka vdek edhe të njëjtit janë kthy se  
19 qashtu ka qenë procedure, janë kthy prej Tirane edhe janë  
20 varros në varrezat e qytetit të Kukësit me nderime ushtarake.  
21 Por ka pas edhe shumë njerëz civil që kanë ardhë për me iu  
22 dhënë lamtumirën e fundit për arsye se ata kanë ra për dheun e  
23 Kosovës dhe në luftën kundra Serbëve.

24 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar. Ju lutem, nëse mundet, e dimë  
25 pak as shumë kohën se kur kanë shkuar në front edhe për

1 ngjarjen, por në veçanti për funeralet, datat i dini se kur  
2 janë zhvilluar këto funerale, me aq sa ju kujtohet?

3 PË. Saktësisht ndoshta nuk e di, por përafërsisht po, por  
4 saktësisht, jo, nuk e di. Me datat, saktësisht nuk e di.  
5 Ndoshta i kam dikun të shënime, por për momentin nuk e di se  
6 cilat kanë qenë data. Por janë bërë edhe në kohërat të  
7 ndryshme. Varet kush se kur ka ra, kur është vra. Janë bërë  
8 disa varrime, jo vetëm një varrim.

9 PY. Dhe një përpjekje të fundit për datat, ishte pak ditë apo  
10 pak javë pasi shkuan në front?

11 PË. Po këta të grupit të Ruzhdi Saramatit, pas disa ditëve që  
12 kanë shku, ndoshta kanë qenë 2-3 ditë, nuk më kujtohet saktë.  
13 Por disa kanë ra edhe më vonë, disa kanë ra edhe në fushat e  
14 minuara nga serbët që i kanë, kur që i kanë qit në kufinin mes  
15 Shqipërisë dhe Kosovës edhe kështu kanë ndodh disa raste. Edhe  
16 të gjitha funeralet, të gjitha varrimet janë bë në varret e  
17 Kukësit që pas lufte atëherë janë tërhek nga aty edhe janë  
18 rivarros në territorin e Kosovës, në Kosovë.

19 PY. Z. Dëshmitar, a keni marrë pjesë ju vetë, a ishit i  
20 pranishëm në ndonjërin prej këtyre funeraleve?

21 PË. Po, gati në të gjitha që kam pas mundësi kam marrë edhe  
22 pjesë.

23 PY. Faleminderit. Z. Dëshmitar, po vijmë në fund të pyetjeve.  
24 Kur mbaroi lufta, siç na thatë rreth qershorit, e lëshuat  
25 Kukësin për t'u kthyer në Kosovë. Çfarë bëtë, ku shkuat kur

1 hytë në Kosovë?

2 PË. Po të gjitha njësitet që kanë qenë në drejtime të  
3 ndryshme, ata e kanë vazhdu rrugën edhe kanë shku në drejtime  
4 të ndryshme, për shembull, drejtimi i që kanë qenë në  
5 drejtimin Gorozhup - Morinë, ata kanë hy dhe janë vendos diku  
6 në periferi të Prizrenit. Drejtime të tjera dikun në një fshat  
7 Gjonaj, disa kanë shku në drejtim të Gjakovës, një njësit --

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Pyetja ishte, ju, ju, vetë ku shkuat?

10 DËSHMITARI: Unë me urdhrin e shefit të shtabit të UÇK-së,  
11 me një grup kemi marrë për detyrë si logjistikë që të t'i  
12 mbledhim të gjitha mjetet ushtarët nuk kanë mujt me bart nëpër  
13 mes bjeshkëve të Pashtrikut me i grumbullu, me i ngarku në  
14 kamiona, në automjete që i kemi pas në përdorim. Edhe gjithë  
15 municionin, armatimin dhe çdo gjë që e kemi pas që e kanë  
16 shfrytëzu ushtarët tonë edhe jemi me marrëveshje, me KFOR-in  
17 kemi shku në drejtim të brezit kufitar në Shqipëri-Kosovë në  
18 Morinë dhe aty kemi hy, aty na kanë prit KFOR-i dhe me ato  
19 mjete kemi, atëherë kemi shku dhe i kemi deponu atje ku na  
20 është thënë ose ku e kemi pas urdhrin për me i deponu ato  
21 armatime.

22 Z. AOUINI: [Përkthim]

23 PY. U vendosët ju vetë në ndonjë qytet pasi i morët dhe i  
24 deponuat armët me ndihmën e KFOR-it?

25 PË. Unë personalisht i kam lajmërue komandantët, e shefit të

1 Shtabit të UÇK-së, në atë kohë që ka qenë Gjenerali Agim Çeku.  
2 Dhe prej atje i kam marrë nja disa ditë pushim për me shku se  
3 nuk e kisha pa familjen time me muaj, e cila ka qenë në atë  
4 kohë në Kroaci, dy vajzat edhe bashkëshortja. Edhe kam shku  
5 për disa ditë me e vizitu së pari familjen. Në të vërtetë, më  
6 së pari kam shkue e kom gjet familjen time këtu që i kam pas  
7 nonën, babën, vllain edhe këta që kanë qenë të dëbum nga  
8 fshati, atëherë pas asajna kam shku për Kroaci. Një herë jam  
9 taku me këta, atëherë kam shku për Kroaci.

10 Z. AOUIINI: [Përkthim] Nëse më lejohet një çast.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
12 mundet.

13 [Mbrojtja këshillohet]

14 Z. AOUIINI: [Përkthim] Të nderuar zotërinj Gjykatës.  
15 PY. Faleminderit, z. Dëshmitar për përpjekjen tuaj të madhe  
16 për të na ndihmuar sot.

17 Ne kaq pyetje kishim, të nderuar Gjykatës.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
19 Faleminderit, z. Avokat. Këtu ka përfunduar pyetjet të cilat i  
20 ka bërë Mbrojtja.

21 Tani është ora 15.55. Do të vazhdojmë nesër me pyetjet të  
22 cilat do t'i bëjë Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe  
23 Mbrojtësi i Viktimave dhe Trupi Gjykses. Për sot, z.  
24 Dëshmitar, ju falënderojmë për përpjekjet tuaja.

25 Ju rikujtoj se nuk duhet që të flisni për dëshminë tuaj

1 këtu me askënd tjetër. Ju këshilloj që të pushoni sonte edhe  
2 do të rishihemi nesër në gjykatë në orën 09.30. Znj. Asistente  
3 e sallë do t'ju shoqërojë të dilni jashtë.

4 DËSHMITARI: Faleminderit edhe prej jush.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Faleminderit. Përpara se të mbyllim për sot, atëherë do të  
7 pyes të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për të ngritur.

8 ZNJ. PERGOLO: [Përkthim] Nuk kemi asgjë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
10 rregull.

11 Z. LAWS: [Përkthim] Po, vetëm një çështje të shkurtër.  
12 Besoj se ju kujtohet se përgjigjet me shkrim nga Dr. Lerz do  
13 të duhet që të dorëzohen, pra, deri më datë 1 nëntor. Jemi në  
14 gjendje që t'i dorëzojmë nesër. Diçka dua të themi të shkurtër  
15 lidhur me atë që do të ecim me këtë pjesë të paraqitjes së  
16 provave që kanë mbetur.

17 Ne do ta parashtrojmë edhe me shkrim, por në thelb është  
18 kjo që çështjet janë trajtuar në mënyrë adekuate, por ne këtë  
19 duam që ta themi edhe me shkrim, ta parashtrojmë edhe me  
20 shkrim kur të dorëzojmë edhe përgjigjen e ekspertës në fjalë.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
22 rregull, kështu do të veprojmë.

23 Avokati Mbrojtës, keni ndonjë çështje për të ngritur para  
24 Trupit Gjykues?

25 Z. AOIINI: [Përkthim] Jo. Asgjë nga ana jonë.



1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
2 rregull. Atëherë bëjmë ndërprerjen e seancë këtu. Do të  
3 ritakohemi nesër në orën 09.30.

4 --- Seanca mbyllet në orën 16.00

5  
6  
7  
8  
9  
10  
11  
12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25